

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5929
E mërkurë, 13 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Gana tërheq njohjen,
MPJ-ja e konsideron
lajm të pavërtetë ■FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BILALL SHERIFI ■FAQE 4-5



PZAP-i KORRIGJOI PADREJTËSINË QË TENTOHEJ T'U BËHEJ 42 MIJË VOTUESVE

Sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, e ka mbrojtur vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për anulimin e votave të ardhura nga Serbia. Në këtë intervistë

dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se me këtë vendim PZAP-i ka korrigjuar padrejtësinë që tentohej t'u bëhej 42 mijë votuesve të Kosovës. Ai ka thënë se shpejtësia e përmbylljes së këtij procesi nuk

duhet të ketë prioritet në raport me saktësinë e leximit të votës së sovranit. Sherifi është shprehur i bindur se rinumërimi i 1 472 kutive do ta rritë numrin e votave për koalicionin Nisma-AKR-PD

PRESIDENTIT FRANCEZ EMMANUEL MACRON NDËRMJETËSON NË PARIS TAKIMIN NË MES TË THAÇIT DHE VUÇIQIT ■FAQE 3

Thaçi: Kosova e gatshme ta vazhdojë dialogun e në fund ta sjellë njohjen

Presidentit francez Emmanuel Macron ka ndërmjetësuar një takim ndërmjet presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe atij të Serbisë, Aleksander Vuçiq, në të cilin është biseduar për mundësinë e vazhdimin të dialogut mes dy shteteve. Presidenti Hashim Thaçi pas këtij takimi ka deklaruar se ka shprehur gatishmërinë e Kosovës që ta vazhdojë dialogun me Serbinë për marrëveshjen e paqes, e cila do ta sjellë njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB



OPINION

GJYKATA
SPECIALE DHE
UÇK-ja F. 06



Izmi ZEKA

AKTUALE

PESË ANKESA I SHKOJNË
GJYKATËS SUPREME PËR
VENDIMIN E PZAP-it F. 3

KOSOVA, VENDTAKIM
I MINISTRAVE TË BUJQËSISË
TË EVROPËS JUGLINDORE F. 6

DREJTORI I POLICISË SHKON NË
VJENË PËR BASHKËPUNIM NË
FUSHËN E SIGURISË F. 6



EKONOMI

'BANKA CREDINS KOSOVË',
BANKA MË E RE NË KOSOVË F. 9

NDËRPRITET GREVA NË
'TREPÇË' F. 9

SPORT

KOSOVA PA MURIQIN KUNDËR
ÇEKISË DHE ANGLISË F. 9



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Pandeli Majko kundër Ramës për "Shengenin Ballkanik"

TRANË, 12 NËNTOR - Ministri i kabinetit "Rama" dhe ish-kryeministri gjatë luftës së Kosovës, Pandeli Majko, ka kundërshtuar idenë e "Mini Shengenit Ballkanik", të propozuar nga Edi Rama dhe presidenti serb Aleksandar Vuçiq. Në një takim me studentët shqiptarë të arkitekturës që studiojnë në Universitetin e Firences në Itali, Pandeli Majko ka deklaruar se Shengenin më i rëndësishëm për Shqipërinë është ai me Italinë dhe jo me rajonin. "Kemi dëgjuar këto kohë të flitet për shumë lloje shen-

geni në rajon, por mendoj se shengenin më i rëndësishëm i Shqipërisë është ai me Italinë", tha Majko. Deklarata e Majkos është një kritikë e drejtpërdrejtë ndaj politikës rajonale që po ndjek kryeministri Edi Rama. Gjatë javës së kaluar, teksa Edi Rama përgatitej për takimin e Ohrit ku bëri deklarata të ashpra kundër Kosovës, mësohet se ka pasur tensione në kabinetin e qeverisë Rama. Ministri i Diasporës nuk e ka përkrahur idenë e kryeministrit, e cila për-

jashton Kosovën nga takimet rajonale dhe afron Shqipërinë me Serbinë. Burime në PS thonë se ka pasur një debat me tone të ashpra në mbledhjen e qeverisë, mes Edi Ramës dhe ministrit të Diasporës, që mban edhe pasaportë si shtetas i Kosovës. Këto debate nuk kanë dalë në publik, por të martën nga Italia, Pandeli Majko ka dhënë sinjalin e parë se është kundër projektit të Edi Ramës me Aleksandar Vuçiqin. Majko është zyrtari i parë i PS-së në postin e ministrit që del

kundër ideve të shefit të tij për projektin e rajonit. Opozita shqiptare ka shprehur kritika për këtë projekt, ndërsa klasa politike dhe shoqëria në Kosovë kanë reaguar shumë ashpër kundër Edi Ramës. Drejtuesit kryesorë të institucioneve të shtetit të Kosovës kanë deklaruar se Edi Rama po mbështet idenë serbe që krijon "Jugosllavinë e re" duke dëmtuar rëndë interesat e Kosovës dhe shqiptarëve në rajon. Kundër kryeministrit Rama dolën presidenti Thaçi, kryemi-



nistri në ilçe, Haradinaj, kryeministri në ardhje, Albin Kurti, lideri i LDK-së, Isa Mustafa etj.

Ndërhyrja ruse në Britani, pse nuk publikohet raporti sekret?

Për raportin e Komitetit të Inteligjencës dhe Sigurisë të Parlamentit britanik, që analizon veprimtarinë ruse në demokracinë e Mbretërisë së Bashkuar, Hillary Clinton tha se është e pashpjegueshme dhe e turpshme që qeveria e këtij vendi nuk e ka publikuar ende këtë raport



Partia Laburiste në opozitë, tha se vendimi për të mos e publikuar raportin para zgjedhjeve të përgjithshme "është i motivuar politikisht". Duke folur në

Parlament, javën e kaluar, ajo tha se raporti mund të ngrejë pyetje për lidhjet midis Rusisë, daljes së Britanisë nga BE-ja dhe udhëheqjes së Tory, partisë që ka pushtetin

në Britani.

Burimet i kanë thënë BBC-së se nuk ka asnjë vërejtje nga ndonjë agjenci apo departament qeveritar për publikimin e raportit, çfarë e lë vendimin në duart e qeverisë. Clintoni tha se ShBA-ja ka pasur problem të ngjashëm në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016, kur ajo është mundur nga republikani Donald Trump. Trumpi dhe fushata e tij, tha ajo, kanë qenë nën hetime për lidhjet e tyre me Rusinë, agentët rusë dhe të tjerët që promovonin interesat ruse, porse publiku amerikan nuk e ka ditur përpara zgjedhjeve. "Pra, nuk ka dyshim për rolin që ka luajtur Rusia në zgjedhjet tona në vitin 2016 dhe që vazhdon ta luajë", tha Clintoni. Ajo tha se raporti për ndërhyrjen ruse në Britani duhet të ketë diçka shqetësuese, pasi nuk po bëhet publik.

Në ShBA, këshilltari i posaçëm, Robert Mueller, i cili ka hetuar ndërhyrjen ruse në zgjedhjet në ShBA, ka konstatuar se ka pasur një të tillë, veçanërisht duke përdorur mediet sociale. Megjithatë, Muelleri ka thënë se nuk ka pasur ndonjë komplot penal midis Moskës dhe fushatës së Trumpit.

Londër, 12 nëntor - Është e pashpjegueshme dhe e turpshme që Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar nuk e ka publikuar ende raportin për ndërhyrjen e dyshuar të Rusisë në politikën britanike, tha në një intervistë për BBC-në, Hillary Clinton, ish-kandidate për presidente të Shteteve të Bashkuara.

Raporti e ka lejen zyrtare, por nuk do të publikohet deri pas zgjedhjeve të 12 dhjetorit në Britani. "Çdo person që voton në këtë vend e meriton ta shohë këtë raport përpara zgjedhjeve", tha Clintoni.

Qeveria britanike mohon se po bën presion për mospublikimin e tij.

Raporti nga Komiteti i Inteligjencës dhe Sigurisë i Parlamentit britanik analizon veprimtarinë ruse në demokrac-

inë e Mbretërisë së Bashkuar. Ai përfshin pretendime për spiunazh dhe ndërhyrje në zgjedhje. Raporti përmban prova nga shërbimet e inteligjencës në Mbretërinë e Bashkuar, të tilla si GCHQ, MI5 dhe MI6, në lidhje me përpjekjet e fshehta ruse për të ndikuar në rezultatin e referendumit për Bashkimin Evropian më 2016 dhe të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017.

Raporti është përfunduar në muajin mars dhe është dërguar në qeverinë britanike më 17 tetor. Por, miratimi për publikimin e tij nuk është dhënë ende dhe kjo nuk do të ndodhë deri pas ditës së zgjedhjeve, më 12 dhjetor.

Kancelari britanik Sajid Javid tha se koha për publikim është "krejtësisht normale" për shkak të natyrës së ndjeshme të përmbajtjes. Por, Emily Thornberry, nga

Policia përplasat me banorët tek "Unaza e Re"

Tiranë, 12 nëntor - Përplasje të forta në orët e para të së martës në zonën e Astirit në Tiranë, ku Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) kishte planifikuar nisjen e prishjes së disa godinave që preken nga projekti i ndërtimit të "Unazës së Re". Sipas një njoftimi të Policisë së Tiranës, "një grup banorësh kanë kundërshtuar me dhunë punonjësit e IKMT-së dhe punonjësit e Policisë. Banorët kanë sulmuar me gurë, sende të

forta dhe bomba moltov punonjësit e Policisë, të cilët ishin planizuar me shërbim. Si pasojë e sulmit mbi Policinë janë plagosur pesë punonjës të Policisë nga FNSh-ja, Shqiponjat dhe Patrullat e Përgjithshme, të cilët u dërguan për ndihmë mjekësore në spitalin ushtarak".

Presidenti Ilir Meta u rreshtua krah banorëve. Përmes një postimi në "Facebook" ai shprehet se është "e papranueshme

dhuna e përsëritur sot ndaj banorëve të 'Unazës së Re' të cilët protestojnë në mbrojtje të shtëpive dhe të pronave të tyre. Arroganca përballë mjerimit dhe traumës që po u shkaktohet këtyre familjeve për muaj të tërë është e patolerueshme", shkruan Meta, ndërsa u bënë thirrje banorëve "ta ruajnë qetësinë dhe të mos bien pre e provokimeve dhe palët të ulen menjëherë për dialog".

Përfaqësues të opozitës ishin



gjatë ditës në zonën e Astirit, ndërsa kryetari demokrat

Lulzim Basha vizitoi të plagosurit në spital.

Presidentit francez, Emmanuel Macron, ndërmjetëson në Paris takim në mes të Thaçit dhe Vuçiqit

Thaçi: Kosova e gatshme ta vazhdojë dialogun e në fund ta sjellë njohjen

Presidentit francez Emmanuel Macron ka ndërmjetësuar një takim ndërmjet presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe atij të Serbisë, Aleksander Vuçiq, në të cilin është biseduar për mundësinë e vazhimit të dialogut në mes të dy shteteve. Presidenti Hashim Thaçi ka deklaruar pas këtij takimi se ka shprehur gatishmërinë e Kosovës që ta vazhdojë dialogun me Serbinë për marrëveshjen e paqes e cila do ta sjellë njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me ndërmjetësimin e presidentit francez Emmanuel Macron, ka takuar të martën në Paris presidentin e Serbisë, Aleksander Vuçiq. Presidenti Thaçi në këtë takim ka shprehur gatishmërinë e Kosovës që ta

vazhdojë dialogun me Serbinë për marrëveshjen e paqes, e cila do ta sjellë njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB. "Në margjina të Forumit të Paqes në Paris, me ndërmjetësimin të presidentit Macron, zhvillova një takim edhe me presidentin e Serbisë. Në këtë takim rikonfirmova se Kosova është e gatshme ta vazhdojë dialogun në kërkim të një marrëveshjeje për paqe, e

cila duhet ta sjellë njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara, por edhe më shumë paqe dhe stabilitet në tërë rajonin tonë", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook". Paraprakisht, presidenti Hashim Thaçi ka marrë pjesë në seancën plenare të Forumit të Paqes në Paris, ku ka folur për angazhimin e arritjes së paqes së qën-

drueshme në Kosovë dhe rajon. Në seancën plenare të Forumit të Paqes në Paris, ku u bënë bashkë udhëheqës shtetesh nga e gjithë bota, është theksuar rëndësia e ruajtjes dhe forcimit të paqes kudo në botë. Presidenti Thaçi ka thënë se Republika e Kosovës vazhdon të mbetet faktor paqes dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor, e përkushtuar gjithnjë për të

dhënë kontribut në sigurinë rajonale dhe globale. "Ne e dimë më së miri sa i rëndësishëm është të jetuarit në një mjedis të qetë dhe paqësor. E dimë, po ashtu, që perspektiva e vetme për një paqe të qëndrueshme në rajonin tonë është integrimi i të gjitha shteteve të Ballkanit në NATO dhe Bashkim Evropian", ka thënë Thaçi.

Në margjina të Forumit të Paqes të Parisit, presidenti ka takuar edhe presidentin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), Peter Maurer, me të cilin ka biseduar për rolin e KNKK-së për zgjidhjen e çështjes së personave të pagjetur në Kosovë.



Thaçi ia dhuroi bibliotekës së Forumit të Paqes në Paris librin kushtuar Nënë Terezës

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se ia ka dhuruar bibliotekës së Forumit të Paqes në Paris librin kushtuar Nënë Terezës. "Bibliotekës së Forumit të Paqes në Paris sot ia dhurova librin 'Nëna e dashurisë' kushtuar Nënë Terezës, e cila është simbol i dashurisë, solidaritetit dhe kujdesit. Populli ynë i dha botës një nënë shumë të dashur për gjithë popujt, e cila me rrugën e saj fisnike ishte simbol i mirësisë dhe mishërim i vetive më të mira njerëzore", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Pesë ankesa i shkojnë Gjykatës Supreme për vendimin e PZAP-it

PRISHTINË, 11 NËNTOR (ER) - Pesë ankesa janë dorëzuar në Gjykatën Supreme rreth rezultateve përfundimtare për zgjedhjet e 6 tetorit nga ana e KQZ-së dhe vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP).

Gjykata Supreme ka bërë me dije se të gjitha ankesat janë individuale të deputetëve. Nga këto ankesa një është nga kandidati për deputet i LDK-së, një nga kandidati për deputet i Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), një nga kandidati për deputet i Partisë Liberale të Ashkalinjëve dhe dy nga kandidatët për deputetë të Lëvizjes

Vetëvendosje. Të gjitha ankesat do të shqyrtohen dhe vendosen brenda afatit ligjor prej 72 orësh nga koha e deponimit të tyre. Sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, në një konferencë për medie ka publikuar një video në të cilën shihen anëtarët e KQZ-së nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje duke kundërshtuar dhe kërkuar që të refuzohen votat nga Serbia, të cilat të hënën i ka anuluar Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës. "Përderisa LV-ja ishte e kënaqur me 29 mandatet që ia ka dhënë populli i refuzonte votat nga Serbia. Por, kur e

pa që përmes 3 000 të tjerave mund t'i grabisë gjashtë mandate të Nismës, atëherë i hoqi maskat. Nga patriotet doli grabitqare. Kjo parti dëshiron t'i grabisë votat që kanë dalë nga 42 mijë votues të Nismës të rregullta dhe të ligjshme përballë 3 140 votave kriminale", ka thënë Sherifi. Kurse nënkryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje, e cila drejtohet nga Albin Kurti, u ka dalë në mbrojtje votave të ardhura jashtëligjshëm nga Serbia, duke kërkuar nga Gjykata Supreme që mos ta pranojë vendimin e PZAP-it. "Kujt ia ka marrë mendja që partia që deklarohet poshtë e përpjetë që s'bën koalicion me



Listën Serbe, sot është bërë avokatja e Listës Serbe, duke bërë ankesë në Gjykatën Supreme ndaj vendimit të PZAP-it që ka

refuzuar votat e jashtëligjshme të ardhura nga Serbia?" ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".



FLET PËR "EPOKËN E RE", BILALL SHERIFI

PZAP-i korrigjoi padrejtësinë që tentohej t'u bëhej 42 mijë votuesve

Sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, e ka mbrojtur vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) për anulimin e votave të ardhura nga Serbia. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se me këtë vendim PZAP-i ka korrigjuar padrejtësinë që tentohej t'u bëhej 42 mijë votuesve të Kosovës. Ai ka thënë se shpejtësia e përmbylljes së këtij procesi nuk duhet të ketë prioritet në raport me saktësinë e leximit të votës së sovranit. Sherifi është shprehur i bindur se rinumërimi i 1 472 kutive do ta rritë numrin e votave për koalicionin Nisma-AKR-PD

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINE, 12 NËNTOR - Sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka vlerësuar lart vendimin e Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) për anulimin e votave të ardhur nga Serbia. Ai ka thënë se një veprim i tillë ktheu integritetin dhe besueshmërinë e zgjedhjeve të 6 tetorit të cilin e kishte dëmtuar KQZ-ja.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Sherifi ka

thënë se PZAP-i ka korrigjuar padrejtësinë që tentohej t'u bëhej 42 mijë votuesve të Republikës së Kosovës. "Vendimi i PZAP-it ka kthyer ligjshmërinë në vend sepse KQZ-ja me një numër të vendimeve të saj të paligjshme ka rrezikuar integritetin dhe besueshmërinë e zgjedhjeve të 6 tetorit. Me këtë vendim të PZAP-it mund të themi se në një masë të madhe është korrigjuar padrejtësia që tentohej t'u bëhej 42 mijë votuesve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë në tërësinë e votave 3

104 vota të ardhura në mënyrë të paligjshme nga Serbia", ka thënë Sherifi.

Për devijimin dhe zvarritjen e këtij procesi ai e ka akuzuar KQZ-në. "Pajtohem se ka zvarritje të këtij procesi, mirëpo fajtor për këtë është KQZ-ja dhe askush tjetër", është shprehur Sherifi. Sekretari i përgjithshëm i Nismës u është përgjigjur edhe kritikëve për zvarritje të procesit zgjedhor. Ai ka thënë se shpejtësia e përmbylljes së këtij procesi nuk duhet të ketë prioritet në raport me saktësinë e leximit të votës, të cilën e ka

riguar padrejtësia që tentohej t'u bëhej 42 mijë votuesve të Republikës së Kosovës duke përfshirë në tërësinë e votave 3 104 vota të ardhura në mënyrë të paligjshme nga Serbia. Prandaj, na vjen mirë që më në fund ligjshmëria u kthye në vend, edhe pse ne konsiderojmë se kjo gjë nuk ka pasur fare nevojë të ndodhë sepse KQZ-ja e ka pasur obligim ligjor të mos lejojë procedimin e atyre votave në asnjë mënyrë, duke pasur parasysh faktin se, siç thotë edhe PZAP-i, nuk ka pasur dërgesa postare nga Serbia, por dorëzim masiv të votave, të cilat më shumë i ngjajnë votimit kolektiv sesa votimit me postë.

"Epoka e re": Në bazë të këtij vendimi koalicioni Nisma-AKR-PD bëhet pjesë e Kuvendit. Por, PZAP-i ka marrë vendim edhe për rinumërimin e 1 472 kutive të tjera. A mund të ndikojë ky rinumërim në rezultat përfundimtar?

Sherifi: Së pari ne besojmë shumë se Nisma ka qenë, është dhe do të jetë pjesë e Kuvendit të Kosovës. Ne i dimë votat tona, e dimë sa vota i kemi marrë në çdo vendvotim dhe e dimë se sa vota i kanë marrë të tjerët. Duke përjashtuar votat e ardhur në mënyrë të paligjshme nga Serbia, ne nuk kemi pasur asnjëherë dilema dhe nuk kemi dilemë se do të jemi pjesë e Kuvendit. Ashtu siç ka ndodhur në procesin e rinumërimit të kutive të para, ne jemi të bindur se edhe në procesin e rinumërimit të këtyre 1 472 kutive të tjera për Nismën do të dalin më shumë vota sesa kemi aktualisht. Trendi ka qenë i tillë, ne gjatë rinumërimit të kutive të para kemi marrë rreth 400 vota më shumë. Pra, besojmë se nuk ka arsye të jetë ndryshe edhe në procesin e rinumërimit të këtyre kutive. Por, sidoqoftë, rendësi ka që gjithçka në këtë proces të jetë e ligjshme. Ne do të pranojmë çdo rezultat që del nga votat e rregullta dhe të ligjshme përmes të cilave qytetarët e Republikës së Kosovës janë përcaktuar për secilën parti se sa mandate do t'i japin.

"Epoka e re": Mirëpo vendimet e fundit të PZAP-it kanë nxitur kritika te disa parti politike dhe shoqëria civile. Si i keni parë këto kritika?

Sherifi: Unë iu bashkëngjitëm këtyre kritikave, mirëpo mendoj se ata e kanë huqur përgjegjësinë e këtij procesi. Përgjegjës për këtë proces është KQZ-ja. Pajtohem se ka zvarritje të këtij procesi, mirëpo fajtor për këtë është KQZ-ja dhe askush tjetër. PZAP-i me vendime e ka kthyer ligjshmërinë në vend. Edhe për partitë që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe për shoqërinë civile, përparësi duhet të ketë cilësia e zgjedhjeve, cilësia e rezultatit, e jo shpejtësia në dëm të cilësdo parti politike. Sepse, në fund të fundit, partitë

politike nuk ekzistojnë për vete, por për qytetarët. Pra, kritikuesit kritikant e tyre duhet t'i adresojnë te fajtori kryesor dhe jo te Nisma apo PZAP-i. Ne ndihemi mirë se çdo gjë që ne kemi konstatuar tani ka dalë e vërtetë.

"Epoka e re": Këto vendime po e zvarrisin procesin zgjedhor dhe po e lëndojnë atë, apo jo?

Sherifi: PZAP-i e ka shpëtuar integritetin e zgjedhjeve dhe besueshmërinë e këtij procesi. Shoqëria kosovare, partitë politike, shoqëria civile kanë qenë para një situatë ta mbështesin vullnetin e 42 mijë votuesve të rregullt apo ta vrasin vullnetin e tyre përmes 3 100 votave kriminale. Në çdo shoqëri demokratike të gjithë mekanizmat e asaj do të ishin ngritur në këmbë për të mos lejuar të preket vullneti i atyre 42 mijë

njerëzve. Unë jam i zhgënjyer në masë të madhe me mungesën dhe ndjeshmërinë publike, sidomos nga shumë aktorë të skenës politike dhe shoqërisë civile, me përjashtim të disa individëve që reagojnë ditë e fundit në funksion të mbrojtjes së ligjit dhe ligjërisë në vend. Ata, para se të jenë kritikë ndaj Nismës, duhet të jenë kritikë ndaj vetes se si arritën që të bien pre e lakmisë për dy-tre mandate të vjedhura, nga një parti politike të tentojnë ta marrin qeverinë e vendit. Kjo është zhgënjyese sepse unë kam pritur që ndjeshmëria publike do të jetë më e lartë edhe te partitë e tjera politike, por dhe te shumë aktorë të shoqërisë civile. Shpejtësia e përmbylljes së këtij procesi nuk duhet të ketë prioritet në raport me saktësinë e leximit të votës të cilën e ka dhënë sovranin.

"Epoka e re": Nëse vendimet e PZAP-it mbesin në fuqi dhe rinumërimi nuk do të sjellë ndryshim në renditjen e subjekteve politike, a mund të presim që Nisma të jetë pjesë e qeverisë së re?

Sherifi: Koalicioni bëhet mbi bazën e gatishmërisë së subjekteve politike për të bashkëpunuar me njëra-tjetrën. Nëse këto dy parti, të cilat kanë filluar një proces të bisedimeve për qeverinë e re, dëshirojnë të bisedojnë edhe me Nismën, besoj se jemi të gatshëm ta shqyrtojmë këtë. Mirëpo për këtë çështje mendoj se mund të flasim vetëm pas certifikimit të rezultatit kur kryetari Limaj do ta thërrasë mbledhjen e kryesisë së partisë dhe aty do të vendoset se si do t'i qasemi kësaj çështje.

Drejtori i Policisë shkon në Vjenë për bashkëpunim në fushën e sigurisë

PRISHTINË 12 NËNTOR (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës (PK-së), Rashit Qalaj, i shoqëruar nga zyrtarë të lartë të PK-së dhe të OSBE-së, po qëndrojnë për një vizitë zyrtare në Vjenë të Austrisë. Gjatë kësaj vizite pritet të realizohen takime të niveleve të ndryshme, përfshirë takime me drejtorin e Byrosë Federale të Antikorrupsionit, drejtorin e Shërbimit të Inteligjencës Kriminale, drejtorin e Policisë së Landit të Vjenës si dhe takime të niveleve të tjera. Të martën janë realizuar

takime me zyrtarët e Sekretariatit të OSBE-së, konkretisht të Departamentit të Kërcënimeve Transnacionale, si me Georgia Holmer, Guy Vinet dhe Deniss Cosgrove, ku janë diskutuar tema të ndryshme, ndër to: terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, krimi i organizuar transnacional, trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i narkotikëve, menaxhimi kufitar, tregtimi ilegal i armëve etj., përfshirë edhe diskutimet rreth konceptit të Policimit të Udhëhequr nga Inteligjenca. Drejtori Qalaj ka falënderuar

zyrtarët e OSBE-së për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme që OSBE-ja ka bërë dhe po bën ndaj Policisë së Kosovës në fusha të ndryshme që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve policore. Këto takime kanë për qëllim rritjen e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral, shkëmbimin dhe rritjen e përvojave për parandalimin dhe luftimin e rreziqeve dhe kërcënimeve në fushën e sigurisë, përfshirë terrorizmin, krimin e organizuar, krimin transkufitar, krimin kibernetik, migrimin ilegal etj.



dhënë sovranin më 6 tetor. "Për partitë që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe për shoqërinë civile, përparësi duhet të ketë cilësia e zgjedhjeve, cilësia e rezultatit dhe jo shpejtësia në dëm të cilësdo parti politike sepse, në fund të fundit, partitë politike nuk ekzistojnë për vete, por për qytetarët. Pra, kritikuesit kritikant e tyre duhet t'i adresojnë te fajtori kryesor dhe jo te Nisma apo PZAP-i. Ne ndihemi mirë, se çdo gjë që kemi konstatuar, tani ka dalë e vërtetë", ka thënë Sherifi. Ai është shprehur i bindur se rinumërimi i 1 472 kutive do ta rritë numrin e votave për koalicionin Nisma-AKR-PD.

"Epoka e re": Z. Sherifi, PZAP-i ka pranuar ankesën e koalicionit Nisma-AKR-PD për largimin e votave të ardhura nga Serbia. Cili është koment juaj?

Sherifi: Vendimi i PZAP-it ka kthyer ligjshmërinë në vend sepse KQZ-ja me një numër të vendimeve të paligjshme ka rrezikuar integritetin dhe besueshmërinë e zgjedhjeve të 6 tetorit. Me këtë vendim të PZAP-it mund të themi se në një masë të madhe është kor-



Kosova, vendtakim i ministrave të Bujqësisë të Evropës Juglindore

EPOKA E Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Kosova e ka marrë presidencën e Grupit Rajonal për Zhvillimin Rural në Evropën Juglindore (SWG) për një periudhë njëvjeçare. Presidenca për kryesimin e këtij grupi i është dorëzuar të martën nga Republika e Maqedonisë së Veriut, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës gjatë takimit të trembëdhjetë të SWG-së i cili sivjet po mbahet për herë të dytë në Prishtinë.

Gjatë këtij takimi, ku kanë marrë pjesë ministra dhe përfaqësues të shteteve të Evropës Juglindore, në mesin e tyre edhe Kosova, është diskutuar për zhvillimet e fundit në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në rajon për përgatitjet rreth zbatimit të IPARD-it dhe reformat e Politikës së Përbashkëta Bujqësore 2021-2027.

Ministrja në detyrë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Zhiviq, gjatë takimit ka theksuar rëndësinë e madhe të platformës së SWG-së që, sipas saj, është një shembull i mirë për shtimin e bashkëpunimit

dhe bashkërendimit të aktiviteteve ndërshtetërore. "Zhvillimi i mëtejshëm i sektorit të bujqësisë vazhdon të jetë një prej prioriteteve tona strategjike dhe me politikatat tona strategjike ndërsektoriale dhe në harmoni të plotë me Politikatat e Përbashkëta Bujqësore të BE-së jemi të orientuar për rritjen e kapaciteteve të prodhimit dhe për krijimin e kushteve sa më të favorshme për prodhuesit në mënyrë që të arrijmë një zhvillim të qëndrueshëm dhe t'u bashkëngjitemi trendeve zhvillimore të vendeve të BE-së", ka thënë ministrja Zhiviq.

Ajo theksoi se do të angazhohen që gjatë presidencës së Grupit Drejtues të Punës për Zhvillim Rural dhe Rajonal në Evropën Juglindore që ta rrisin edhe më tej bashkëpunimin rajonal brenda këtij grupi, me qëllim të avancimit të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Gjatë këtij takimi ministrat dhe udhëheqësit e delegacioneve të vendeve të Evropës Juglindore u njoftuan edhe për hapat që BE-ja është duke ndërmarrë për Politikatat e Përbashkëta Bujqësore (PPB) dhe Politikatat

për Zhvillimin Rural (PZHR). Udhëheqësi i Drejtorisë së Përgjithshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Komisionin Evropian, Mario Milouchev, gjatë prezantimit të këtyre politikave, tha se në rrugën drejt bashkimit, organizatat si SWG janë një mundësi shumë e mirë për ta koordinuar formimin e politikave bujqësore dhe rurale në rajon. "Bashkëpunimi rajonal është thelbësor për suksesin tuaj. Duke pasur parasysh që administratat tuaja janë të vogla e bëjnë më të vështirë përballimin e të gjitha ndërlikimeve të politikave të BE-së, por në këtë rrugë bashkëpunimi vizitat studimore dhe shkëmbimi i praktikave më të mira mund të ndihmojnë shumë në këtë aspekt", ka thënë ai.

Përfaqësuesit e delegacioneve të shteteve të Evropës Juglindore, të cilët kanë diskutuar rreth formave të bashkëpunimit dhe reformave në Politikën e Përbashkëta Bujqësore, sonte do të mbajnë edhe takime bilaterale me ministrat Zhiviq, me ç'rast do të diskutojnë edhe për forma të tjera të bashkëpunimit ndërshtetëror me Kosovën.

KDI: OShP-ja ta tërheqë urdhëresën që legjitimon prokurime mbi bazën e dokumentit të dyshuar si i falsifikuar

PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), gjatë analizës së vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), që ndërlidhen me prokurimet në nivel qendror, ka gjetur se OShP-ja në urdhëresën e saj dërguar Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP), më 11 nëntor 2019, ka kërkuar nga kjo e fundit që, në bazë të një dokumenti të kundërligjshëm, të kthejë në rivlerësim tenderin tre milionësh për "furnizim me pemë dhe perime". "AQP-ja fillimisht kishte anuluar këtë tender në mungesë të numrit të mjaftueshëm të operatorëve ekonomikë të përgjegjshëm. Lidhur me njërin operator të 'papërgjegjshëm' në këtë tender, AQP-ja kishte gjetur se ky i fundit në proces të aplikimit dhe rishqyrtimit kishte paraqitur vërtetimin tatimor me numër të njëjtë serik me të dhëna të ndryshme. Me këtë rast, AQP-ja kishte kërkuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ta konfirmojë saktësinë e këtij vërtetimi, ndërsa nga ATK-ja kishte marrë përgjigje se ky dokument i prezantuar nga Operatori Ekonomik nuk përkonte me gjendjen në sistemin e ATK-së", është thënë në reagimin e KDI-së. KDI, thotë se, përkundër këtij fakti të prezantuar nga AQP, OShP-ja kishte vendosur ta aprovojë ankesën e OE dhe kishte kërkuar nga AQP ta kthejë në rivlerësim tenderin, duke injoruar kështu përgjigjen e ATK-së. "Arsyetimi i OShP-së se 'falsifikimi' i dokumentit të ATK-së është 'devijim i vogël në

pajtim me nenin 59, pika 4 e Ligjit të Prokurimit Publik', sipas KDI-së nuk qëndron. Në fakt, ai përbën vepër penale të keqpërdorimit dhe mashtrimit në prokurim publik. Kodi Penal i Republikës së Kosovës falsifikimin e dokumenteve publike dhe legalizimin e përmbajtjes së rreme i klasifikon si vepra penale. Neni 415, Pika 1 e Kodit Penal, precizon që 'kushdo që me vetëdije shkel rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënie të kontratës së prokurimit publik, duke paraqitur dokumentacion të rremë, marrëveshje të fshehtë kundërligjore apo ndërmerr ndonjë veprim tjetër të paligjshëm me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik dhe me qëllim të ndikimit në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik, dënohet me gjobë dhe burgim deri në pesë (5) vjet', thuhet në reagimin e KDI-së.

KDI kërkon nga OShP-ja që urgjentisht ta tërheqë urdhëresën për mosanulim të tenderit deri në zbardhjen e dyshimeve për paraqitjen e dokumenteve me përmbajtje të rreme nga operatori në fjalë. Gjithashtu, KDI-ja u bënë thirrje organeve kompetente që ta hetojnë rastin në fjalë.



KPK-ja mban dy seanca dëgjimore për zbatimin e Ligjit për përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Këshilli Prokurorial i Kosovës ka mbajtur të martën takimin e radhës, të cilin e ka udhëhequr kryesuesi Bahri Hyseni, me ç'rast ka shqyrtuar dhe miratuar pikat e parapara të rendit të ditës.

KPK-ja në fillim të takimit ka aprovuar raportin e mekanizmit përcjellës ndërinstitucional së bashku me disa rekomandime për veprat penale karakteristike për periudhën janar-shtator 2019, të cilin e ka prezantuar drejtori i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve, Valon Jupa.

Gjithashtu, në vijim të këtij takimi janë shqyrtuar raportet e

komisioneve për rishqyrtim për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për Kryeprokuror të Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë Themelore të Prishtinës si dhe janë miratuar pjesërisht rekomandimet e këtyre komisioneve me rastin e kundërshtimeve të kandidatëve për kryeprokurorë të këtyre dy prokurorëve.

Në fund të takimit, Këshilli Prokurorial ka mbajtur dy seanca dëgjimore për zbatimin e Ligjit për përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe ka trajtuar disa çështje të tjera nga fushëveprimtaria e tij.



Policia e Kosovës ndalon 27 azilkërkues

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Policia e Kosovës ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se 27 persona, shtetas të huaj, për të cilët dyshohet se vijnë nga Siria, Afganistani dhe Libia, kanë hyrë ilegalisht në territorin e Kosovës dhe kanë kërkuar azil. "Patrulla e Stacionit Policor në Fushë-Kosovë ka njoftuar Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj, se te rrethi në Fushë-Kosovë ka takuar 27 per-

sona shtetas të huaj, që dyshohet se vijnë nga Siria, Afganistani, Libia të cilët kanë kërkuar azil", thuhet në përgjigjen e policisë. Sipas policisë, ndaj këtyre 27 personave nuk po zhvillohen hetime, por personat në fjalë janë trajtuar sipas Ligjit për Azil dhe janë vendosur në Qendrën e Azilit. Vendet e Ballkanit kanë shërbyer si korridor për shumë migrantë që kanë ikur nga zonat e luftës

dhe varfëria. Ata përdorin territorin e këtyre vendeve për të arritur në vendet e pasura në Perëndim. Agjencia Evropiane e Kufijve, Frontex, po vazhdon bashkëpunimin me disa vende të Ballkanit përmes kontrolleve të përbashkëta kufitare. BE-ja vendosi t'i dërgojë njësitet e veta kufitare në këto vende, pas fluksit të migrantëve në të ashtuquajturin "Korridori i Ballkanit".



Gana tërheq njohjen, MPJ-ja e konsideron lajm të pavërtetë



Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës ka njoftuar opinionin se nuk ka asgjë të vërtetë në lidhje me pretendimet e ministrit serb, Ivica Daçiç, për tërheqjen e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Gana. Ndërkaq AFP-ja ka raportuar se Ministria e Jashtme e Ganës ka njoftuar për tërheqjen e njohjes për Kosovën

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Gana e ka tërhequr njohjen e Kosovës ka bërë me dije për agjencinë e lajmeve France Presse (AFP), Ministria e Punëve të Jashtme e këtij vendi të Afrikës Perëndimore. "Qeveria e Ganës ka vendosur ta tërheqë njohjen

e Kosovës si një shtet i pavarur", i tha zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Ganës, Charles Owiredu, agjencisë AFP. Ai ka thënë se arsyet e tërheqjes së njohjes i janë komunikuar edhe Serbisë. "Vendimi për njohjen e Kosovës doli të ishte i parakohshëm", thuhet në njoftimin e autoriteteve të Ganës. "Gana e ka marrë parasysh dia-

logun midis Serbisë dhe Kosovës që synon zgjidhjen e çështjes", është thënë në njoftim.

Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Ivica Daçiç, ka deklaruar të hënën se Gana e ka tërhequr njohjen e pavarësisë së Kosovës. Ndërkaq Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës ka njoftuar opinion-

in se nuk ka asgjë të vërtetë në lidhje me pretendimet e ministrit serb, Ivica Daçiç, për tërheqjen e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Gana. "Republika e Kosovës është njohur nga 116 vende anëtare të OKB-së, përfshirë këtu edhe Republikën e Ganës. Ministria e Punëve të Jashtme është në komunikim të rregullt me

ambasadat e Ganës në qendra të ndryshme të botës dhe asnjëra prej tyre nuk kanë asnjë informacion në lidhje me pretendimin e ministrit serb. Është e habitshme se si disa media, edhe në Kosovë, transmetojnë të pavërteta të servuara nga institucionet e Serbisë dhe përmes 'fake news' domosdo i shkaktojnë dëm Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj", është thënë në njoftimin e MPJ-së.

Sipas këtij njoftimi të MPJ-së, "gazetarët kanë kapacitet për ta kuptuar seriozitetin e shtetit dhe betejat diplomatike me të cilat ballafaqohet Republika e Kosovës, andaj në këtë pikë duhet të tregohen shumë më të kujdesshëm dhe më profesionistë në mënyrë që të mos bien pre e propagandës serbe e cila nga Beogradi zyrtar prezantohet si lajm". "Metodat e mirënjohura dhe të bazuara në shembuj të tjerë që po i përdor Daçiçi me lobuesit e tij me histori të dyshimtë kriminale, janë në proporcion të zhdrejtë me politiken paqësore rajonale, paqen dhe harmoninë në mes të shteteve. Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës fton të gjitha mediat në Kosovë dhe jashtë saj që ta verifikojnë më shumë se njëherë secilin lajm për Kosovën, i cili prodhohet në Serbi, duke e ditur mirëfilli se pas krimeve kundër njerëzimit, përpjekjeve për ta kryer gjenocidin dhe për ta shndërruar Kosovën në tokë të djegur, Beogradi zyrtar tashti qëllim esencial ka mohimin e shtetësisë së Kosovës", është theksuar në njoftimin e MPJ-së.

Fillon trajnimi për policë të rinj

VUSHTRRI, 12 NËNTOR (ER) - Më 11 nëntor ka filluar trajnimi për policë të rinj në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. Mirëseardhje kadetëve të rinj u uruan eprorët e lartë në kuadër të Divizionit të Trajnimit të Policisë së Kosovës dhe drejtori i AKSP-së. Ky trajnim do të zgjasë nëntë muaj dhe kadetët e

rinj do të trajnohen sipas praktikave më të mira evropiane për policinë demokratike. Përmbajtja e këtij trajnimi ka të bëjë me: kryerjen e aktivitetëve të përgjithshme policore, ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlihen me policinë, policimi në bashkësi, rendi dhe siguria publike, armët e zjarrit, siguria

në komunikacion, hetimi i veprave penale dhe kundërvajtjeve, mbikëqyrja dhe kontrolli i kufirit shtetëror, taktikat mbrojtëse etj. Pas përfundimit të këtij trajnimi policët e rinj do të caktohen në stacione policore për të vazhduar me trajnimin fushor (praktik).



Krasniqi: Bizneset kërkojnë uljen e tarifave nga bankat komerciale

EPOKA E RE | Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Kamata prej pesë përlindësh për kthimin e parave të imëta, tarifat në Master dhe Visa Card, POS-ët, rritja e tarifave për regjistrimin e makinave për 26 për qind, mundësia e kufizuar e deponimit të parave dhe mungesa e sigurisë gjatë deponimit në ATM, ishin disa nga arsyet për të cilat Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka mbajtur të martën konferencë për media. Kryetari i OAK-ut, Skënder Krasniqi, ka thënë se Oda e Afarizmit të Kosovës gjatë këtij viti ka pasur dy takime me guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, ku u kanë shprehur shqetësimet bizneseve lidhur me këto probleme. "Kamata prej pesë përqindësh është një problem që përballen bizneset të cilat kanë punë me para metalike, për kthimin e tyre në kartëmonedha. Pra, për 1 000 euro pësojnë humbje 50 euro. Me këtë ballafaqohen më së shumti furrat e bukës dhe marketet, të cilat më së shumti kanë para metalike që rrjedhin nga shitja e produkteve të tyre",

ka deklaruar Krasniqi. Ai ka rikujtuar se lidhur me këto çështje OAK-u, së bashku me sektorin e bukëpjekësve, ka bërë një peticion të cilin ua ka dërguar kryeministrit, ministrit të Financave, ministrit të Tregtisë dhe Industrisë dhe ministrit të Zhvillimit Ekonomik më datë 31.12.2018 si dhe ka realizuar dy takime me guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ku janë informuar se kjo kamata është vendosur nga BQK-ja dhe e cila do të shqyrtohet për largim por që, sipas tij, ende nuk kanë ndërmarrë asgjë. Krasniqi ka thënë se Kosova ka tarifat më të larta të Master dhe Visa Card në rajon, derisa në Serbi tarifat në shkëmbim janë 0.2 për qind deri 0.3 për qind, Kosova për transaksione më pak se 25 euro e ka 0.8 për qind apo 400 për qind më të lartë dhe tarifat e tjera variojnë nga 1.2 për qind deri 2 për qind apo rritje nga 600 për qind deri në 1 000 për qind më të larta. "Tarifat e pagesave nga POS-ët në markete po sillen nga 1.3 për qind deri në 2 për qind, kjo po i zhgënjën qytetarët që të bëjnë pagesa me kartela për shkak të tarifave të



larta. Bankat kanë garancionet e veta dhe kjo nuk duhet t'i vihet në barrë biznesit dhe qytetarit", është shprehur Krasniqi. Oda e Afarizmit të Kosovës ka ftuar edhe një herë Bankën Qendrore të Kosovës që t'i marrë parasysh këto vërejtje dhe t'u dalë në ndihmë bizneseve dhe qytetarëve, pasi kjo do të ndikojë në

rritjen e pagesave, rritjen e biznesit dhe zvogëlimin e informalitetit në vend. Qëndrim Kryeziu, pronar i biznesit anëtar në OAK "ISP Broadcast", ka përmendur disa prej problemeve me të cilat po ballafaqohen bizneset siç janë, numri i ulët i bankomateve dhe numri i degëve të bankave në

komuna. Sipas tij, shqetësim tjetër është mungesa e sigurisë gjatë deponimit në ATM, kufizimi i shumës që deponohet dhe mundësia e deponimit të parave "cash" në ATM. Kryeziu ka deklaruar se këto po u shkaktojnë ngarkesë të madhe financiare bizneseve dhe është duke i dëmtuar në punën e përditshme të tyre.

'Banka Credins Kosovë', banka më e re në Kosovë



PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Në mbledhjen e së martës Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ka miratuar kërkesën nga subjekti "Banka Credins Kosovë" për licencim si bankë në Republikën e Kosovës. "Kërkesa për licencim nga 'Banka Credins Kosovë', e dorëzuar në Bankën Qendrore gjatë këtij viti, është vlerësuar pozitivisht, duke u bazuar në kërkesat e Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe të Rregullores për

Licencimin e Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja", është thënë në njoftimin e BQK-së. Sipas këtij njoftimi, subjekti "Banka Credins Kosovë" ka paraparë të ofrojë në tregun bankar të vendit tonë një gamë të gjerë të shërbimeve bankare bashkëkohore me kushte konkurruese. Themelues dhe aksionar i vetëm i saj është "Banka Credins Sh. A." nga Shqipëria, e cila operon nga viti 2003 dhe është një prej bankave më të mëdha. Më tutje, në njoftimin e BQK-së thuhet se gjatë periudhës së

ardhshme, konform legjislacionit në fuqi, subjekti "Banka Credins Kosovë" duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore për fillimin e operacioneve të saj. "Rrjedhimisht, me përcaktimin afirmativ të Bankës Qendrore rreth plotësimit të këtyre kushteve, subjekti 'Banka Credins Kosovë' kualifikohet që potencialisht ta marrë licencën për të operuar si bankë e re në vendin tonë, gjë për të cilën opinioni publik do të informohet me kohë", është bërë me dije në këtë njoftim.

Shqipëria, ndër më të varftrat e Evropës në 2019-n

TIRANË, 12 NËNTOR - Edhe gati tri dekada pas kalimit në ekonominë e tregut, shqiptarët që jetojnë në një vend të bekuar nga zoti, me bukuri të shumta e pasuri natyrore, vijojnë të jenë ndër më të varfrit e Evropës. Statistikat e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të përditësuara në "Pasqyrën Ekonomike Globale tetor 2019", tregojnë se të ardhurat për frymë të pritshme të shqiptarëve ishin 5 732 dollarë për vitin 2019, duke e pozicionuar Shqipërinë në vendin e 102 në botë nga 192 shtete gjithsej, në nivele të

ngjashme me Irakun, Paraguain, Libanin, Libinë etj. Në Evropë, Shqipëria është ndër vendet me të ardhurat për frymë më të ulëta dhe për këtë e kalon në renditje vetëm Kosova (4 442 dollarë për frymë, në vend të 111) dhe shtetet e ish-Bashkimit Sovjetik si Ukraina (vendi 125), Moldavia (128). Nga vendet e rajonit, Mali i Zi ka të ardhura për frymë prej 8 703 dollarësh, ose 62 për qind më të larta se të shqiptarëve (vendi 72). Më pas vjen Serbia, në vend të 87 me 7 398 dollarë për frymë, Maqedonia e Veriut (6 096 dollarë në vend të

95-të), Bosnja (vendi 97). Të dhënat e FMN-së referojnë se edhe një dekadë më parë Shqipëria ishte e pandryshuar në vend të 102-të, në një tregues që rritja ekonomike e vendit nuk ka arritur të jetë më e lartë se e fqinjëve, apo se ajo nuk ka prodhuar mirëqenie për qytetarët e saj (sipas të ashtuquajturit proces i koncergjencës, vendet me të ardhura më të ulëta duhet të rriten më shpejt, në mënyrë që ta kapin mesataren e Bashkimit Evropian). Sot vendet e Bashkimit Evropian kanë të ardhura mesatare për



frymë në vit prej 35.8 mijë dollarësh, ose gati shtatë herë më të

larta sesa të shqiptarëve, sipas shifrave të FMN-së.

Ndërpritet greva në 'Trepçë'

**EPOKA ERE****A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Minatorët e Kombinatit Metalurgjik "Trepça" kanë ndërprerë grevën e nisur për shkak të pakënaqësive të tyre lidhur me pagat dhe kushtet e punës. Lajmin e ka bërë me dije kryesuesi i Bordit të "Trepçës", Ardian Syla, i cili ka thënë se, pas negociatave nga të

gjitha palët në ndërmarrjen "Trepça", puna në minierën e Stantërgut, pas një ndërprerje dyditore, ka rifilluar. "Pas negociatave nga të gjitha palët në ndërmarrjen 'Trepça', bordit, menaxhmentit, sindikatës si dhe punëtorët e ndërmarrjes 'Trepça', puna në minierën e Stantërgut, pas një ndërprerje dyditore, ka rifilluar. Kohët e fundit 'Trepça' është duke u përbal-

lur me gjendje jo të mirë financiare. Në mungesë të prodhimit kemi pasur edhe jolikuiditet financiar, prandaj ka pasur edhe vonesa për ekzekutimin e pagave si dhe obligimeve të tjera. Ndërmarrja 'Trepça' është ndërmarrje prodhuese, prandaj edhe gjithë funksionimi i saj varet nga nxjerrja, përpunimi dhe prodhimi i koncentratit", ka thënë ai. Syla ka bërë me dije se pagat për

muajin tetor si dhe pjesa e mbetur e dy muajve paraprak do të ekzekutohen shumë shpejt, pas liferimit të sasisë së grumbulluar të koncentratit të plumbit dhe zinkut. "Rregullimi i cilësisë së ushqimit si dhe kushtet e tjera të punës për punëtorët në minierë janë në përfundim e sipër. Tremujori i fundit ka qenë shpresëdhënës duke treguar trend të rritjes së prodhimit,

prandaj Trepçës i është kthyer shpresa sado e vogël për një stabilitet financiar. Prandaj, çdo grevë eventuale vetëm se do ta pengonte zhvillimin e mëtutjeshëm të ndërmarrjes", ka thënë Syla. Ai ka falënderuar të gjithë punëtorët e "Trepçës" për mirëkuptimin e tyre si dhe kontributin e dhënë ndër vite në zhvillimin e ndërmarrjes "Trepça".

Dogana ka testuar derivate të naftës për të cilët s'ka qenë e akredituar

PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka prezantuar raportin e auditimit të performancës "Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve të naftës". Në këtë raport thuhet se laboratorit i Doganës ka testuar parametra që kanë të bëjnë me derivate të naftës për të cilët nuk ka qenë i akredituar dhe nga muaji prill i vitit 2019 ka kryer testime pa akreditim.

Shkurta Stublla, anëtare e ekipit, ka deklaruar se Dogana nuk i ka të përcaktuara të drejtat e qasjes në sistem elektronik dhe nuk ka kryer riakreditimin. "Laboratori i Doganës ka testuar parametra për të cilët nuk ka qenë i akredituar dhe nga muaji prill i vitit

2019 ka kryer testime pa akreditim. Një pjesë e derivateve të naftës është liruar pa pasur raport të bashkangjitur në sistem. Deri më tani Dogana nuk e ka kryer riakreditimin. Te procesi i akreditimit kemi parë që nuk ka pasur trupa inspektues dhe të laboratorëve. Pikat e shitjes së derivateve nuk janë me program në bazë të analizës së riskut", është shprehur Stublla. Kurse Drilon Shala, udhëheqës i ekipit, ka përmendur disa të gjetura të tjera të raportit. "Ka pasur mungesë të trupave inspektuese për marrjen e mostrave dhe mungesë të informatave. Trupa inspektuese ka përdorur aplikim të standardit të dyfishtë dhe kjo nuk ka ofruar



siguri. Pasojat e mungesës së monitorimit nuk janë të vogla sepse trupat inspektuese nuk kanë pasur autorizim", ka deklaruar ai. Ndërkaq Vlora Spanca, ndih-

mëse e Auditorit të Përgjithshëm, ka thënë se objektiv ka qenë monitorimi i cilësisë së ajrit. "ZKA-ja, përveç auditimit të rregullsisë, kryen edhe auditime të performancës,

që synon që institucionet publike të ofrojnë shërbime të mira për qytetarët. ZKA-ja mbetet e përkushtuar që të kryejë auditime që janë në interes për qytetarët. Cilësia e derivateve ka rëndësi për një ambient të pastër. ZKA-ja është motivuar ta kryejë këtë auditim. Objektiv ka qenë monitorimi i cilësisë së derivateve para se atyre t'u bëhet tregu i brendshëm. Kontrolli i këtyre produkteve është përcjell me mangësi. ZKA-ja ka angazhuar edhe ekspertin e fushës për ta kryer këtë auditim. Pa bashkëpunimin e Doganës dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Auditimit nuk do të ishte i mundur", ka thënë Spanca.

'Bregu i Diellit' në Prishtinë bëhet me kënd të lodrave për fëmijë

PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se është funksionalizuar këndi i lodrave për fëmijë në lagjen "Bregu i Diellit" në kryeqytet. Po ashtu, kjo komunë ka bërë

me dije se kënde të tilla do të ketë edhe në lagje të tjera të Prishtinës. "Fëmijët e lagjes 'Bregu i Diellit' tash e tutje kohën e lirë do të mund ta kalojnë me më shumë lojëra, aktivitete e

sport. Këndi i lodrave në këtë lagje është pjesë e projektit të Drejtorisë së Sportit. Kemi edhe disa të ngjashme në lagjet e tjera", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Në Kamenicë hapet ekspozita multimediale 'Tribunali i Hagës: Rasti i Kosovës 1998-1999'

Kamenicës, 12 nëntor (ER) - Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Kamenicë dhe përkrahjen e Ambasadës së Zvicrës në Kosovë, kanë bërë hapjen e ekspozitës multimediale "Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ): Rasti i Kosovës 1998-1999".

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se kjo ekspozitë prezanton hetimet, rekonstruktivet dhe ndjekjen e krimeve në Kosovë. "Nëntë videot e paraqitura në kohëzgjatje prej 97 minutash ofrojnë dëshmi për negociatat e dështuara dhe fillimin e konfliktit në Kosovë", ka thënë Kastrati. Kjo ekspozitë do të qëndrojë e hapur deri të premten nga ora 09:00 deri në orën 16:00, në palestrën e qytetit të Kamenicës. Me këtë rast, Komuna e Kamenicës ka ftuar të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në ekspozitë.



Haziri në Athinë prezanton shembullin e Gjilanit për integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta



GJILAN, 12 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, me ftesë të UNICEF-it është duke marrë pjesë në konferencën "Mayors for Children", e cila po mbahet në Athinë. Në këtë konferencë janë duke marrë pjesë kryetarë të komunave nga regionin në mbështetje të fëmijëve dhe të drejtave të tyre, ndërsa Komuna e Gjilanit përfaqësohet nga Lutfi Haziri, duke sjellë shembullin e orga-

nizimit, mbrojtjes dhe integrimet e fëmijëve me nevoja të veçanta. "Gjilani është zgjedhur si komunë për implementim të programit të UNICEF-it për trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Ne po punojmë për integrimin e fëmijëve në shkolla, përmes ndihmës që ofron sektori i arsimit dhe mirëqenies sociale, në mënyrë që të integrohen që në fëmijërinë e hershme. Qëllimi ynë është që fëmijët me

nevoja të veçanta të ndihen dhe të jetojnë të barabartë në shoqëri", ka thënë Haziri. Në kuadër të bashkëpunimit me UNICEF-in, Komuna e Gjilanit ka bërë një hulumtim për gjendjen e deritanishme të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijët e braktisur, ku përfshihen statistika lidhur me ofrimin e asistencës nga kjo komunë për këta fëmijë, në bashkëpunim me aktorët lokalë.

Fillojnë punimet në segmentin e rrugës "17 Shkurti" në Skenderaj

SKENDERAJ, 12 NËNTOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se kanë filluar punimet në segmentin e rrugës "17 Shkurti" në zonën urbane të këtij qyteti. Ky projekt përfshin tre segmente të rrugëve në këtë pjesë të qytetit.

Në fillimin e punimeve të pranishëm ishin edhe kryetari i kësaj komunë, Bekim

Jashari, nënkryetari Nuredin Lushtaku, drejtoresha e Urbanizmit, Sanije Ahmeti, inxhinierë dhe bashkëpunëtorë. Me këtë rast, kryetari Jashari ka theksuar se ruga "17 Shkurti" do të bëhet moderne. "Sot filluan punimet në segmentin e rrugës '17 Shkurti' në qytet, ku së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku dhe

bashkëpunëtorë pamë nga afër fillimin e punimeve. Ky projekt që përfshinë tre segmente të rrugëve, përveç që do ta përmirësojë infrastrukturën rrugore në këtë zonë urbane, do të bëhet mjaft moderne dhe atraktive për banorët. Kjo pjesë e qytetit pa dyshim se do të jetë ndër pjesët më të bukura të Skenderajt", ka thënë Jashari.



Gjykata Speciale dhe UÇK-ja



Izmi ZEKA

Në valën e ftesave krerëve të UÇK-së dhe jo vetëm krerëve, shkruhet e thuhet se krerët e saj paskëshin bërë krime apo se nuk paskan bërë krime nga pala tjetër. Shkruhet e thuhet në televizione, portale, gazeta... se kjo gjykatë është e padrejtë apo se kjo gjykatë duhej pat-

jetër për të larguar nga skena politike komandantët "e korruptuar", madje shkruhet e thuhet se ky do të jetë çlirimi i vërtetë i Kosovës. Provohet të argumentohet se kjo gjykatë nuk është kundër UÇK-së po kundër komandantëve "të korruptuar, kriminelë e vrasës". Çuditërisht për më shumë se njëzetë vjet kështu shkruhet e thuhet edhe në Serbi. A do të thotë kjo se individë e grupime në Kosovë me apo pa vetëdije janë zgjatim i politikës serbe. A do të thotë kjo se vlera më e madhe që ka krijuar në gjithë historinë populli i Kosovës, pra UÇK-ja, po u pengon edhe atyre që për çfarëdo arsye nuk ishin rreshtuar krahas saj.

UÇK-ja nuk është fikcion. Ajo ishte reale e konkrete dhe atë e krijuan e rritën bashkërisht emrat konkretë, ushtarë e komandantë, ndaj është injorancë e skajshme të thuhet se nuk po goditet UÇK-ja, po vetëm ca komandantë. Thuhet e shkruhet pastaj se vetë këta komandantë e krijuan këtë Gjykatë. Po, po... shumë e vërtetë edhe kjo.

Ama nuk shkruhet e thuhet pse e bënë këtë. Harrohet të thuhet se pikërisht propaganda serbe e instaluar edhe në Kosovë përmes individësh e grupesh me e pa vetëdije...gjithë këto vite mbajtë në shënjestër këta komandantë, dhe në një pikë u rrit

edhe presioni e edhe besueshmëria në këtë propagandë, ndaj komandantëve të involvuar në politikë nuk u mbeti gjë tjetër pos të zhvillonin edhe një betejë tjetër - atë të dëshimit të pastërtisë e madhështisë së luftës së UÇK-së.

Rezultativisht, Gjykatën Speciale e formuan të gjithë ata që me e pvetëdije goditën komandantët, duke harruar se ata tashmë ishin në struktura politike. Pikërisht ky fakt e pengoi në vazhdimësi dikë, prandaj vrap për të shpikur krime... për t'i propaganduar ato, për "të gjetur" të tjera krime, për të identifikuar vrasësit me motive politike, për ta bërë gogol SHIK-

un. Ishte lojë e bukur e propagandës serbe nuk ka dyshim dhe e shërbimeve të fshehta të saja, nga e cila humbës jemi të gjithë që e duam këtë vend. Harruam se edhe vrasjet me motive politike fare lehtë ka mundur t'i bëjnë shërbimet e huaja, veçanërisht ai serb, sepse ata e dinin se ne do ta fajësonim veten tonë. Fatkeqësisht ia dolën, teksa ne (disa) gjetëm faktorët - SHIK-un dhe komandantët. Tani na mbetet të besojmë se komandantët do ta fitojnë edhe këtë betejë, sepse një ditë do ta shohim ç'i kemi bërë apo ç'kemi tentuar t'i bëjmë vetes sonë.

Atëherë do të themi "lavdi" marrëzisë dhe injorancës tonë!

Reagim i KMDLNj-së

Kush po vonon me qëllim formimin e institucioneve të Kosovës, test demokratik për PDK-në dhe AAK-në!

U bë më shumë se një (1) muaj kur u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë e që procesi zgjedhor u vlerësua me nota të larta nga vendorët dhe ndërkombëtarët që monitoruan këtë proces. Këto zgjedhje, përveçse krijuan një realitet tjetër në skenën politike kosovare që e nxorën fitues LV-në, kurse të dytën LDK-në, e krijuan një standard të munguar demokratik për opozitën e cila më parë kontestonte rezultatin e zgjedhjeve sikur që bënin 100 mijë lojëra për të mbetur në pushtet. Tash, PDK-ja dhe AAK-ja u kualifikuan me shumë sukses si opozitë konstruktive për faktin se menjëherë apo dy (2) orë pas përfundimit të zgjedhjeve pranuan rezultatin e zgjedhjeve dhe u deklaruan se do të kalojnë në opozitë e që ishte e paimagjineshme më herët.

Realisht, KMDLNj ka pritur që institucionet e Kosovës të formohen shpejt për faktin se LV-ja dhe LDK-ja ishin deklaruar për koalicion edhe parazgjedhor e që do ta lehtësonte koalicionin paszgjedhor për faktin se këto dy subjekte politike kanë fituar 50 për qind të vendeve në Kuvendin e Kosovës.

Bisedimet për koalicion janë stërzgatur dhe kushtëzuar për poste të caktuara e që po ndikon në dinamikën e formimit të Qeverisë së Kosovës.

Pastaj, 450 vendvotime janë dërguar (me vendim të Gjykatës Supreme) në rinumërim sikur

që koalicioni NISMA-AKR-PD kanë kundërshtuar votat e ardhura nga Serbia shkaku se këto vota ishin dhe janë përcaktuese nëse ky koalicion do të jetë pjesë e Kuvendit ose jo.

Pasi KQZ shpalli rezultatet e zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, subjektet dhe kandidatët e pakënaqur me rezultate u ankuan në PZAP, pas së cilës votat nga Serbia u anuluan sikur që thuhet 1 600 vendvotime do të dërgohen në rinumërim, nëse vendimin e PZAP-it e vërteton edhe Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të ankesave eventuale.

Votat e ardhura nga Serbia përbëjnë elemente të aktivitetit kriminal, falsifikim të të dhënave dhe janë krim i organizuar e që është toleruar në të gjitha zgjedhjet paraprake për ta ruajtur pushtetin apo për të ardhur në pushtet, sidomos pas formimit të Listës Serbe. Tash këto vota po kundërshtohen për faktin se janë përcaktuese, në njërin anë për fatin e koalicionit NISMA-AKR-PD dhe, në anën tjetër, krijojnë një situatë ku legalizohet shantazhimi për formim të koalicionit qeverisës duke e kushtëzuar LV-në si fitues e zgjedhjeve.

Ende nuk kemi një vendim të Gjykatës Supreme dhe nga minoritetet ka filluar shantazhimi me dhënie të ministrive sikundër vlerë e votës për koalicion të ri qeverisës.

PDK-ja dhe AAK-ja e kanë krijuar një standard të ri

demokratik me pranimin e menjëhershëm të rezultateve dhe deklarimi se do të bëhen opozitë konstruktive duke e ndryshuar pakëz perceptimin e krijuar për këto dy subjekte politike, se me asnjë çmim nuk heqin dorë nga pushteti dhe, për këtë arsye, KMDLNj-ja mendon se pikërisht tani PDK-ja dhe AAK-ja janë para testit të radhës së pranimit dhe zbatimit të demokracisë. PDK-ja dhe AAK-ja duhet ta votojnë pa asnjë kusht qeverinë Kurti dhe me këtë do t'i nxirrin nga loja shantazhuesit e paskrupullt sikur që do të kontribuonin në

përsheptimin e ndërtimit të institucioneve të Kosovës e që është edhe detyrim i një opozite konstruktive. Pavarësisht prej vendimit të Gjykatës Supreme, PDK-ja dhe AAK-ja duhet ta votojnë qeverinë Kurti si votim teknik, kurse me përpikëri do ta monitoronin programin qeveritar, gjithashtu nga pozita e opozitës konstruktive: gjatë çdo dështimi do të reagonin me të gjitha mjetet e lejuara demokratike, kurse çdo përparim do ta përkrahnin.

KMDLNj kërkon përgjegjësi nga anëtarët e KQZ-së dhe liderët politikë që zbatojnë standarde

të dyfishta, kur kanë interes e përkrahin PZAP-in dhe Gjykatën Supreme, kurse kur ndihen se janë humbës në mënyrën më të paskrupullt e përbaltin punën e këtyre institucioneve duke ushtruar presion të drejtpërdrejtë në marrjen e vendimeve.

Krejt në fund, për KMDLNj-në është i papranueshëm fakti se, përkundër të gjitha lëshimeve me vota nga Serbia dhe rinumërimin të mbi 60 për qind të vendvotimeve, askush nuk i është nënshtruar asnjë përgjegjësi në kohën që duhet të ketë edhe përgjegjësi penale.



Jimmy Carter shtrohet në spital

UASHINGTON, 12 NËNTOR - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Jimmy Carter, u shtrua në një spital në Atlanta për një procedurë në tru. Qendra Carter tha se ish-presi-

dentit duhet t'i lirohet presioni, i shkaktuar nga gjakderdhja. Carter, 95 vjeç, është udhëheqësi më i vjetër i gjallë i Shteteve të Bashkuara. Ai ka qenë presidenti i 39 dhe ka

shërbyer nga viti 1977 deri më 1981.

Carter është mundur në garën për rizgjedhje nga Ronald Reagan.

Që pas largimit nga Shtëpia e

Bardhë, ai ka mbetur aktiv, duke bërë punë humanitare me Qendrën e tij Carter.

Në vitin 2002 ai ka marrë Çmimin Nobel për Paqe për vepra humanitare.



Tensione të larta në prag të takimit Trump - Erdogan

Takimi i kësaj jave midis presidentit amerikan Donald Trump dhe atij të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, vjen në kohë kritike për marrëdhëniet midis dy vendeve aleate të NATO-s, ku ofensiva e Turqisë kundër milicisë kurde në Siri pritet të jetë temë kryesore e diskutimit midis tyre

UASHINGTON, 12 NËNTOR - Këtë javë presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan viziton Uashingtonin, ku do të takohet me presidentin amerikan Donald Trump. Takimi shihet si mundësi për t'i përmirësuar raportet që u tensionuan nga dallimet në disa qëndrime.

Ofensiva e Turqisë kundër milicisë kurde në Siri pritet të jetë temë kryesore e diskutimit midis dy presidentëve, Trump dhe Erdogan. Për Ankaranë ushtarët kurdë janë terroristë, por ata janë aleati kryesor në betejën e udhëhequr nga ShBA-ja kundër Shtetit Islamik.

Kongresi amerikan ka kërcënuar me fuqizim të sanksioneve kundër Turqisë, disa prej të

cilave do ta godasin personalisht Erdoganin. Takimi i kësaj jave midis dy presidentëve vjen në kohë kritike për marrëdhëniet midis dy vendeve aleate të NATO-s. "Është një listë e gjatë e problemeve midis dy vendeve. Në fakt, marrëdhënia kurrë nuk ka qenë kaq e keqe. Çështje me rëndësi është sulmi i Turqisë në Siri dhe kundërshtimi i ShBA-së. Situata në terren është e paqëndrueshme" - thotë Asli Aydintasbas i Këshillit Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë.

Pavarësisht prej tensioneve, dy presidentët duket se kanë ndërtuar marrëdhënie të mira bashkëpunimi, gjë që në Ankara shihet si mundësi për një riafirmim të tyre. "Samiti historik do



të sjellë përfitime për të dyja palët. Unë e shoh me optimizëm. Kjo do të sjellë zgjidhje dhe mundësi të reja mes dy aktorëve", thotë Mesut Casin, këshilltar i presidentit turk. Por disa analistë thonë se pritja e zgjidhjes, duke u mbështetur vetëm te Trumpi, mund të jetë strategji e rrezikshme. "Ishte një

gabim i madh strategjik që marrëdhënia të varet te presidenti Trump, te një njeri dhe te postimet e tij në rrjete sociale. Është e gabuar. Do të thosha se është një ruletë ruse në marrëdhënien që është më e vjetër se një shekull", thotë Asli Aydintasbas. Erdogan pret nga presidenti Trump ta heqë embargon për

blerjen e avionit të fundit luftarak amerikan. Kjo masë erdhi si përgjigje ndaj blerjes nga Turqia të sistemit rus S-400 për mbrojtje nga raketat.

Uashingtoni është i alarmuar nga thellimi i lidhjeve të Ankarasë me Moskën.

Gjatë vizitës së tij, pritet që Erdogani ta ofrojë blerjen e raketave amerikane.

Ankaraja thotë se nëse ky takim nuk përmirëson raportet ShBA-Turqi, Moskë është në pritje. "Turqia nuk mund të ketë aleancë produktive me ShBA-në, ndërkohë që këto kërcënime vazhdojnë në maksimum. Kjo nuk sjell përfitime. Kur shoh se kush përfiton nga situata, këto janë Rusia dhe Kina", thotë këshilltari për politika të jashtme i presidentit turk, Mesut Casin.

Në Siri qysh tani ka filluar bashkëpunimi i trupave turke dhe ruse.

Presidenti rus Vladimir Putin pritet ta përcjellë me kujdes vizitën e presidentit Erdogan në Uashington.

BE-ja miraton planet për prodhim të armëve të reja mbrojtëse

BRUKSEL, 12 NËNTOR - Qeveritë e Bashkimit Evropian dhanë të martën dritën e gjelbër për 13 projekte të reja mbrojtëse, një hap që synon prodhimin e më tepër armatimeve në mënyrë të pavarur nga Shtetet e Bashkuara. Sipas planeve, me të cilat ranë dakord ministrat e mbrojtjes të BE-së në Bruksel, do të fillojë puna për një anije të re patrullimi, një armë elektronike zhurmimi për avionët dhe teknologji për gjurmimin e raketave balistike.

Për negociimin e projekteve u

deshën shumë muaj. Javën e kaluar presidenti francez Emmanuel Macron nënvizoi dëshirën për një bashkëpunim më të thellë në fushën e mbrojtjes mes vendeve të BE-së, duke thënë se aleanca mbrojtëse e NATO-s, e drejtuar nga ShBA-ja, është "në vdekje klinike".

Rreth 47 projekte të përbashkëta mbrojtjeje mes vendeve të BE-së janë tashmë në proces e sipër pas nënshkrimit të një pakti nga Franca, Gjermania dhe 23 qeveri të tjera të bllokut në fund të vitit 2017. Pakti synon financimin,



zhvillimin dhe stacionimin e forcave të armatosura nga këto vende pas vendimit të Britanisë

për t'u larguar nga BE-ja. Çdo armë e re në tokë, det, ajër ose në hapësirën kibernetike

mund të vihet në dispozicion të NATO-s, por vënia në pikëpyetje e rëndësisë së aleancës nga presidenti amerikan Donald Trump, iu ka dhënë shtysë të re përpjekjeve evropiane të mbrojtjes.

Presidenti Macron ka shprehur dyshime lidhur me parimin bazë të NATO-s se një sulm ndaj një aleati është sulm ndaj të gjithëve. Megjithatë, shumë aleatë evropianë e kundërshtojnë portretizimin që ai i ka bërë NATO-s si një aleancë e vdekur. NATO-ja do të mbajë një takim të nivelit të lartë në Londër më 4 dhjetor.

Pendarovski vitin e ardhshëm viziton Moskën



SHKUP, 12 NËNTOR - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, të martën ka informuar shefin e diplomacisë ruse, Sergej Lavrov, se më 9 maj do ta vizitojë Moskën. Në një video të publikuar nga Ministria e

Jashtme ruse dëgjohej presidenti maqedonas duke i thënë Lavrovit se ambasadori i tyre në Shkup ishte habitur kur kishte dëgjuar për qëllimin e tij dhe kishte pyetur vazhdimisht nëse kjo gjë ishte e vërtetë, ka njoftuar

"Alsat". "Më tha, nuk ju duhet kohë për të menduar? Unë i thashë jo. Një nga shtyllat themelore të shtetit tim është lufta kundër fashizmit, kështu që absolutisht unë do të jem atje", i thotë Pendarovski,

Lavrovit. Nga kabineti i presidentit e kanë konfirmuar këtë informacion, duke theksuar se Pendarovski do të marrë pjesë në paradën tradicionale në Moskë për Ditën e Fitores mbi Fashizmin, 9 Maj.



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Kapet peshku i çuditshëm

Thellësia e detit vijon të rezervojë surpriza të tmerrshme. Në një video të publikuar në rrjetet sociale shfaqet një krijesë e frikshme e detit. Dhëmbë të mprehtë dhe të frikshëm, gojë të madhe dhe grupin që ta sjellë në kujtesë një ngjalë. Imazhet datojnë në vitin 2016, por ripublikimi i tyre nga peshkatarë nga Malajzia ka bërë xhiro nëpër botë.




FOTO E DITES



Pamje nga teleferiku i qytetit La Paz në Bolivi. /Reuters/

E rrallë

Ora më e shtrenjtë në botë shitet për një shumë marramendëse

Ora më e shtrenjtë në botë është shitur në një ankand bamirësie në Zvicër. Patek Philippe u shit për një shumë marramendëse prej 31 milionë dollarësh në Christie. Ajo është një nga orët më komplekse të krijuara ndonjëherë. Ora e markës luksoze zvicrane u ble një nga person anonim të shtunën që lamë pas.



BARSOLETA E DITËS



Në palestër:

- Shkon një i ri në palestër dhe i thotë trajnerit: Dua të bëhem joshës për femrat. Kur t'ia filloj?
- Trajneri: Njëherë dillo nga bankomati!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Jeni shumë të ndjeshëm sot dhe emotiviteti juaj do të jetë ngjites. Në ambientin shoqëror do t'ju bashkohen edhe miqtë në të njëjtën gjendje.



DEMI

Veprimet shkojnë paralelisht me mendimet tuaja se si duhet finalizuar një projekt. Keni qenë gjithmonë mjaft praktik dhe kjo ju ndihmon ngado.



BINJAKËT

Sot jeni të fokusuar vetëm te ndjenjat dhe te dashuria. Për ata që janë çift, partneri është kryefjala e ditës, ndërsa për të tjerët po ëndëroni për dikë që e keni pranë.



GAFORRJA

Intuita juaj ju ka ndihmuar ta zgjidhni opsionin e duhur në një marrëveshje të fundit.



LUANI

Mendja juaj ka kohë që mendon për vende të largëta. Doni të zhvendoseni diku, por do të jetë një vendim përfundimtar.



VIrgjËrEsha

Do të dëgjoni shumë fjalë sot, por asnjëra prej tyre nuk do të rezultojë e vërtetë në fund të ditës, duke bërë që të dilni keq përpara një miku.



PESHORJA

Keni një ngërç në raport me partnerin që nuk po arrini ta tejkaloni as ju e as pala tjetër. Do t'ju çojë drejt një ftohjeje më të madhe.



AKREPI

Yjet nuk janë në anën tuaj sot dhe do t'ju pengojnë në ato pjesë të ditës që i mendonit si më të mirat dhe më të realizuarat.



SHIGJETARI

Keni mjaft punë për të mbyllur sot, edhe ato gjëra që i keni lënë për një moment të dytë, por që nuk mund të presin më.



BRICJAPI

Stabiliteti dhe mirëqenia e familjes suaj janë ato që po ju shqetësojnë sot. Një problem i lindur së fundmi ju ka vënë në mendime.



UJORI

Nuk është një nga ato ditët më të mira kjo e sotmja, por do të dini t'i jepni ngjyra, edhe pse paraqitet shumë gri.



PESHQIT

Duket sikur kjo ditë e parë e muajit nuk është edhe aq e gëzueshme, por me kalimin e orëve çdo gjë do të rregullohet në favorin tuaj.

Christina Aguilera shijon turneun në Londër, shfaqet në skenë me vajzën



Ajo është duke shijuar turin e saj botëror në mbështetje të albumit të tetë, Liberation. Ndaj Christina Aguilera bëri shfaqjen e saj në Wembley Arena në Londër, me një paraqitje familjare, ndërsa solli vajzën e saj Summer Rain

bashkë me të në skenë. Këngëtarja 38-vjeçare mbante në krah vajzën e saj, ndërsa këndonte Let There Be Love, një këngë vallëzimi nga albumi i saj i shtatë Lotus. Aguilera kishte zgjedhur të vishej me të kuqe dhe të zezë për t'i argëtuar fansat.

Gwen Stefani iu përgjigjet thashethemeve për fejesë



Gwen Stefani u është përgjigjur thashethemeve se ajo është fejuar me Blake Shelton pasi iu pa një unazë diamanti në gisht. 50-vjeçarja sqaroi se unaza ishte thjesht një aksesor. "Mund të jetë një unazë e vërtetë, një diamant i vërtetë, por nuk është një unazë martese", ka

thënë Gwen për "E! News". Ajo shtoi se kur ata të fejohen do t'i njoftojë të gjithë fansat. "Kur kam diçka për të thënë, do ta them", ka deklaruar Gwen. Ndërsa Gwen dhe Blake nuk janë fejuar, por janë në lidhje që katër vjet dhe duken shumë të lumtur pranë njëri-tjetrit.



Hilaria Baldwin pëson abort

Hilaria Baldwin ka njoftuar se ka pësuar një abort. Gruaja 35-vjeçare e Alec Baldwin, hyri në "Instagram" për ta dhënë lajmin e dhimbshëm. "Ne jemi shumë të mërzhitur për të treguar se foshnja jonë ndërroi jetë në katërmujorin e tij", ka shkruar Hilaria nën video. "Ne duam që ju

ta dini se, edhe pse nuk jemi mirë tani, do të jemi. Ne jemi aq me fat për katër fëmijët tanë të shëndetshëm dhe kurrë nuk do ta heqim vëmendjen nga kjo. Unë jam e shkatërruar tani. Nuk e prisja këtë kur shkova në kontroll sot. Unë nuk e di çfarë tjetër të them. Jam ende në shok", ka shkruar Baldwin.

Zayn Malik bashkohet me familjen



Zayn Malik është rikthyer në Mbretërinë e Bashkuar në një vizitë në familjen e vet. Ai qëndroi në Britani për ditëlindjen e nënës së tij, Trisha, e cila bëri festë për 50-vjetorin e lindjes. Malik uroi motrën e vet shtatzënë e cila tashmë ishte martuar. Ish-ylli i One Direction

jeton tani në Shtetet e Bashkuara dhe nuk ishte në gjendje të marrë pjesë në ceremoninë kur motra e vogël Safaa u martua me të dashurin Martin Tiser. Javë më vonë ajo njoftoi se çifti priste fëmijën e parë së bashku pasi pozuan për fotografi në një dush për fëmijë.

BISEDË ME KRISZTIÁN CSAPLÁR-DEGOVICS, ALBANOLOG DHE HISTORIAN HUNGAREZ; NXËNËS I ALBANOLOGUT DHE PËRKTHYESIT HUNGAREZ ISTVAN SCHUTS.

Shqipja dhe hungarishtja, dy nga gjuhët unike të Europës



Bisedoi: Mimoza Hasani PLLANA

Çfarë ju ka motivuar kaq shumë sa të mësoni gjuhën shqipe?

Krisztián Csaplár-Degovics: Pikësepari gjithmonë kam pasur dëshirën që të jem historian, që merret me historinë e Europës Lindore dhe gjithmonë kam qenë në kërkim të një historie të caktuar kombëtare, interesante në një kuptim të gjerë, për studimin e së cilës kërkohet përgatitje dhe shkathësi shkencore specifike. Në universitet jam marrë me historinë polake, sllovaqe dhe rumune, në përpjekje për të gjetur një periudhë, personalitet apo territor intrigues për t'ia dedikuar përpjekjet e mia shkencore – por ende pa sukses. Pas disa muajve dhe viteve humba interesimin tim për këto vende. Së dyti, unë kam studiuar shkencat arkivore në universitet (1997-2002). Më 1999 kam marrë pjesë në një trajnim në Arkivat Kombëtare të Vjenës organizuar nga Delegacioni Arkivor i Hungarisë në Austri. Ka qenë një përvojë e jashtëzakonshme për mua dhe u dashurova me dokumentet që ofronin Arkivat Kombëtare të Austrisë. Së treti, u ndesha me historinë shqiptare shumë vonë. Ka qenë viti 1999 kur isha duke lexuar monografinë e profesorit austriak Karl Kaser mbi fiset shqiptare (Hirten, Kampf, Stammeshelden). Kam qenë i fascinuar të mësoj se 4-500 kilometra larg nga Hungaria ekzistonte një shoqëri mirë e organizuar fisnore në fillim të shekullit. Në një moment kur sapo kisha përfunduar së lexuari librin e Kaser, u ndesha me emrin e Nopças dhe dokumentet për të në Arkivat kombëtare vjeneze. U dashurova me personalitetin e tij dhe fillova së shkruari tezën e magjistraturës mbi aktivitetin e Nopças më 1911 në Shqipërinë e Veriut, duke u mbështetur në burimet arkivore të papublikuara të Arkivës kombëtare austriake. Pas diplomës së parë, vendosa që të merrem me historinë shqiptare me intensitet të shtuar dhe në mënyrë profesionale: në muajt e parë kur fillova studimet doktorale e vizitova prof. Schutzin për të marrë pjesë në seminarin e tij gjuhësor.

Sikur edhe gjuha hungareze edhe gjuha shqipe është e veçantë, jo e lehtë për t'u mësuar dhe për t'u folur derisa nuk jeton në vendet shqipfolëse. Sa mbani kontakte fizike me shtetet europiane ku gjuha shqipe është gjuhë zyrtare: Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e zi?

Krisztián Csaplár-Degovics: Gjuha shqipe i takon familjes së gjuhëve indoeuropiane, kështu që marrëdhënia me strukturën gramatikore të saj është e lehtë. Vështirësitë e të mësuarit së shqipes rrjedhin nga fjalori i saj i veçantë dhe dialektet e së folmes. Që nga viti 2004 lexoj publikimet e historiografisë shqiptare (nganjëherë përdor fjalorin), letërsi, veprat e intelektualëve shqiptarë etj. Kështu që mendoj se kapacitetet e mia lexuese janë të mira. Kam studiuar historinë e Europës juglindore në Minhen dhe Vjenë (2002-2004) dhe që nga ajo kohë kurrë nuk i kam shkëputur kontaktet e mia me mësuesit dhe miqtë shqiptarë; ne komunikojmë në gjuhën gjermane dhe shqipe. Në tri vitet e fundit kam marrë pjesë në disa konferenca ndërkombëtare në Tiranë dhe Prishtinë dhe kam filluar të mbaj korrespondencë me historianë dhe shkencëtarë shqiptarë, të cilët nuk i kam njohur më parë.

Fushat tuaja të studimit i përkasin kërkimeve politike, historike, kulturore të popullit shqiptar, nga të cilat keni marrë informacione edhe për gjuhën, traditën kulturore, historinë dhe zakonet e shqiptarëve, andaj a mund të na thoni si e çfarë e dallon gjuhën shqipe dhe popullin shqiptar në mesin e gjuhëve dhe popujve ballkanikë?

Krisztián Csaplár-Degovics: Ngjashëm sikur gjuha hungareze, gjuha shqipe është një "gjuhë ishull". Në fqinjësi të saj nuk ka gjuhë të tjera që kanë ngjashmëri me të. Për shkak të këtij 'pozicioni ishullor' bota shqipfolëse krijon një territor të mbyllur në Ballkan dhe nuk është e vështirë që të dallohen veçoritë kryesore ndërmjet gjuhës shqipe me gjuhën greke dhe sllave. Nga pikëpamja e historianëve, ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjuhëve të vendeve fqinje: ka burime të pakta me vlerë, të shkruara në gjuhën shqipe para fundshekullit të 19-të.

Historia e albanologjisë njeh emra të shquar albanologësh nga koha e Autro-Hungarisë dhe sot.

Kujtojmë dy albanologët e dalluar, një nga të parët Franz Nopcsa dhe Istvan Schuts, kontribuesin e madh të kohës sonë. A mund të na thoni a ka ndikuar vepra e tyre në studimet tuaja?

Krisztián Csaplár-Degovics: 'Mësuesi i parë' pa dyshim ka qenë Nopça, pastaj Lajos Thallóczy të cilin shoqëria shqiptare nuk e njeh mirë. Nopça ka qenë shkencëtar i madh, ndërka Thallóczy ka luajtur një rol të rëndësishëm në proceset e formimit të kombit dhe shtetit shqiptar ndërmjet viteve 1896 dhe 1916. Pas njohjes me Nopçan dhe Thallóczyn, kanë qenë profesorët, kolegët dhe miqtë e mi austriakë, bavarezë dhe shqiptar në Mynhen, Vjenë dhe Grac të cilët ma prezantuan albanologjinë austro-hungareze (Karl Kaser, Peter Bartl, Konrad Cleëing, Oliver J. Schmitt, Jonida Xhyra, Kurt Gostentschnigg, Eva Anne Frantz, Bardhyl Demiraj). Ata më ndihmuan t'i artikuloj pikëpamjet e mia apo të shndërrohem në një pasardhës hungarez të albanologjisë austro-hungareze.

Unë mësova gjuhën shqipe vetëm një semestër nga prof. Schutz. Në vend të mësimit të gjuhës, ai preferonte që të tregonte anekdotat mbi kulturën dhe shoqërinë shqiptare. Për këtë arsye unë shkova në Mynhen, që ta mësoj gjuhën shqipe dhe albanologjinë. Në përgjithësi, unë kam pasur profesorë austriakë, gjermanë dhe shqiptarë, dhe jo profesor Schutzin. Edhe pse nuk llogaritem si student i prof. Schutz, bëj shumë përpjekje që trashëgimia e tij të vlerësohet dhe të kujtohet si në Hungari, ashtu edhe në vendet ka banojnë shqiptarët. Kam respekt për aktivitetin e tij jetësor dhe shkencor.

Të flasim pak për njërin ndër albanologët më të njohur në Europë në shek. XX., Istvan Schuts, që la pas vetes studime monumentale lidhur me prejardhjen e gjuhës shqipe. A mund të na kujtoni z. Schuts sipas njohjes suaj?

Krisztián Csaplár-Degovics: Aktiviteti shkencor dhe jetësor i prof. Schutz ka ngjallur debate në

Hungari. Ai ka qenë një shkencëtar i 'vetëshpallur (vetëbërë)' dhe një linguist autodidakt. Për shkak të hendeqeve shkencore të tija, sipas meje, linguistët hungarezë kanë refuzuar ta pranojnë në mesin e tyre. Publikimet në hungarisht të Schutzit kanë qenë cak i sulmeve shkencore në kolumne në revista të njohura hungareze. Thënë të vërtetën, ai nuk ka mundur t'i bindë kritikët hungarezë për pikëpamjet e tij. Kjo ka qenë ndër arsyet kryesore pse ai filloi t'i publikojë punimet e tij shkencore në gjuhë të huaja dhe për këtë arsye ai është ndër më i respektuar në revista ndërkombëtare shkencore. Sa i përket sfondit të njohurive historike, personalisht i vlerësoj qëndrimet e tij me një dozë kritike. Librat në hungarisht të prof. Schutz, që kanë trajtuar të kaluarën historike të Ballkanit, rrallëherë janë të dobishme për studentët dhe historianët. Në anën tjetër, këto libra kanë qenë ndër librat e para në gjuhën hungareze, të cilat kanë hulumtuar periudhën më interesante dhe më së paku të



hulumtuar të Europës Juglindore para fillimit të mileniumit të ri. Për ta përmbledhur, nëse dikush dëshiron ta vlerësojë të kaluarën shkencore të Schutzit ai duhet ta hulumtojë ndikimin e tij në shoqërinë e shkencëtarëve shqiptarë. Besoj se ndikimi i tij dhe kujtesa për Shutzin, po ashtu ka një anë emocionale, përbrenda historisë së albanologjisë. Prof. Schutz filloi të merret me albanologji, filloi të komunikojë me shkencëtarët shqiptarë nga Kosova dhe Shqipëria në një periudhë të rëndësishme, atëherë kur shqiptarët trajtoheshin si qytetarë të rangut të dytë në Jugosllavi dhe nga një botë e ndarë nga lufta e ftohtë. Prof. Schutz i motivuar dhe i shtyrë nga personaliteti i tij, interesimet e tij të vazhdueshme, gjithmonë i ka konsideruar shqiptarët, kulturën dhe gjuhën e tyre si vlera të përgjithshme të njerëzimit (dhe kjo është arsyeja pse aktiviteti i tij jetësor mund të jetë pjesë e traditave të mira të albanologjisë).

Lidhjet shqiptaro-hungareze janë të hershme, nga koha e dy figurave kombëtare Skënderbeut dhe Hunyadi, për të vazhduar në kohën tjetër të përkrahjes së madhe që AustroHungaria dha për krijimin e shtetit shqiptar, pastaj me lidhjen martesore të Mbretit Zog me vajzën (Mbretëreshën Geraldinë) e njërës prej familjeve të njohura hungareze, Apponyi. Në shekullin që po jetojmë (XXI), Hungaria radhëhet nga shtetet e para që njohu pavarësinë e Kosovës. Çfarë do të veçoni nga marrëdhëniet shqiptaro-hungarezebrenda periudhës tuaj të studimeve?

Krisztián Csaplár-Degovics: Sa i përket lidhjeve historike shih pjesë në pyetjen e 8-të. Jam dakord me ju se ngjarjet kryesore që kanë shënuar lidhjet hungarezo-shqiptare ndërlidhen me bashkëpunimin e Skënderbeut me Huniadin, lindjen e albanologjisë në Perandorinë Habsburge (1850), rolin austro-hungarez në proceset e formimit të kombit dhe shtetndërtimit tek shqiptarët (1896-1960), ekspeditat hungareze në territoret shqiptare (1916-1918), martesat ndërmjet mbretit Zog dhe Geraldinës, marrëdhëniet shkencore 1945-1955 dhe njohjes së pavarësisë së Kosovës.

Çfarë jeni duke punuar tani në kontekst të studimeve ballkanike?


Krisztián Csaplár-Degovics: Tani jam duke redaktuar një liber shkencor mbi marrëdhëniet historike, politike, kulturore dhe shkencore shqiptaro-hungareze (prej shekullit 15 e deri më tani). Dymbëdhjetë studime, ku paraqiten përpjekje për të dhënë detaje mbi situatat konkrete historike në të cilat historitë kombëtare të shqiptarëve dhe hungareze janë përpjekur (Skënderbeu dhe Huniadi; familja Arianiti në Hungarinë

otomane të shekullit të 16-të; aktiviteti i Gjergj Balshës në Hungari; Pjetër Mazreku; Toma Raspasani; Lajos Thallóczy dhe formimi i kombit shqiptar; detashmenti austrohungarez në Shkodër më 1913; Nopcja në kampanjën ushtarake austro-hungareze në vitin 1916; 25 vjetori i pavarësisë në Tiranë më 1937; mbretëresha Geraldinë; marrëdhëniet shqiptaro-hungareze gjatë luftës civile greke 1946-1949; pavarësia e Kosovës dhe Hungaria) dhe katër përmbledhje mbi lidhjet shkencore (historia e albanologjisë hungareze; marrëdhëniet arkeologjike ndërmjet Hungarisë dhe Shqipërisë; botanistët hungarezë në territoret e banuara me shqiptarë; albanologjia dhe linguistikën hungarezë). Ky libër studimor dhe shkencor është shkruar nga historianët dhe shkencëtarët më të shquar hungarezë dhe financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Hungarisë. Në anën tjetër, synoj që të shkruaj një monografi mbi shtetin e parë shqiptar (1912-1914) nga perspektiva ndërkombëtare dhe globale.

Krisztián Csaplár-Degovics: U lind më 1976. Në vitin 2000, mbaroi studimet për Historinë e Përgjithshme në Universitetin e Budapestit, Eötvös Loránd. Më 2003, mbaroi studimet në Shkencat e Arkivit, në po të njëjtin Universitet, ku edhe vazhdoi studimet doktorale në fushën e Shkencave Historike, programi: Historia e Europës Lindore të shekullit XIX dhe XX, të cilat i mbaroi në vitin 2008. Kërkimet shkencore të CSAPLAR-DEGOVICS, i përkasin Historisë së Shqipërisë, Serbisë, Kosovës dhe Maqedonisë, si dhe studime të tjera të lidhura me politikën ballkanike të monarkisë së Austro-Hungareze. Nga arritjet akademike, veçohet puna e tij si këshilltar i lartë i kërkimit dhe udhëheqës i ekipit kërkimor për studime të Europës Juglindore në Akademinë e Shkencave në Hungari, si asistent profesor në Departamentin e Historisë së Europës Lindore në Universitetin e Budapestit, Eötvös Loránd. Deri tani, ka publikuar me dhjetëra punime shkencore në fushën e studimeve të marrëdhënies kulturore dhe historike të vendeve të Ballkanit. Është anëtar i "Shoqatës së Studimeve Austriake", anëtar i "Institutit Shqiptar" në Mynih, anëtar i komisionit të përbashkët të historianëve bullgaro-hungarez, etj. Është përfitues i disa bursave të studimit në vende të ndryshme europiane. Në vitin 2008, është nderuar me çmimin Péter Hanák, që ndahet për studiuesit e rinj të historisë së Europës Qendrore.

Bisedë e shkëputur nga libri: "Shtegtimi i shqipes në Europë" botuar nga OLYMP, Prishtinë, 2019./Kultplus

Letra e famshme që Anjshtajni i dërgoi të bijës: Po të tregoj të vërtetën për Zotin



Albert Ajnshtajni u lind më 14 mars të vitit 1879. Ai është një nga fizikanët dhe shkencëtarët e njohur në të gjithë botën. Ka qenë fitues i çmimit Nobel në vitin 1921 ndërsa ka pasur 3 nënshtetësi, atë gjermane, zvicerane dhe amerikane. Thuhet se koeficienti i dijes së trurit të Ajnshtajnit është 165. Ajnshtajni vdiq në Princeton të Neë Jersey, më 18 prill të vitit 1955 në moshën 76-vjeçare. Më poshtë është letra e famshme që Ajnshtajni i shkroi vajzës së tij.

LETRA

"Kur propozova teorinë e relativitetit shumë pak njerëz më kuptuan. Ajo çfarë do të zbuloj tani për njerëzimin gjithashtu do të pritet me keqkuptim dhe paragjykim. Po të kërkoj të ruash letrat e mia për sa kohë të jetë e nevojshme: vite, dekada, derisa shoqëria të ketë bërë aq progres sa të arrijë të pranojë çfarë do të shpjegoj më poshtë. Ekziston një forcë kaq e fuqishme sa deri sot shkencën nuk ka arritur t'i gjejë një shpjegim. Është një forcë që përfshin dhe i sundon të gjithë; që fshihet pas çdo fenomeni në univers. Kjo forcë është dashuria.

Kur shkencëtarët kërkonin për një teori të unifikuar të universit harruan më të fuqishmen forcë të padukshme. Dashuria është dritë që ndriçon ata që e japin dhe e marrin. Dashuria është gravitet, sepse i bën disa njerëz të tërhiqen nga të tjerë. Dashuria është pushtet, sepse shumëfishon më të mirën tonë dhe i bën njerëzit mos të humbasin në egoizmin e verbër. Dashuria shpaloset dhe zbulon. Për dashurinë jetojmë dhe vdesim. Dashuria është Zoti dhe Zoti është dashuri. Kjo forcë jep shpjegimin e gjithçkaje, i jep kuptim jetës. Është pikërisht ajo që kemi anashkaluar për kaq shumë kohë, mbase sepse kemi frikë nga dashuria, sepse është e vetmja energji në univers që njeriu nuk ka mësuar ende ta manipulojë.

Për t'i dhënë dashurisë vendin që meriton bëra një ndryshim të thjeshtë në ekuacionin tim më të famshëm. Nëse në vend të $E=mc^2$ të pranojmë se energjia që shëron botën mund të përftohet nga shumëzimi i dashurisë me shpejtësinë e dritës në katror do të arrinim në përfundimin se dashuria është forca më e fuqishme që ekziston... sepse nuk njeh limite.

Pas dështimit të njerëzimit në shfrytëzimin e forcave të universit që na janë kthyer kundër është e rëndësishme që të ushqejmë një tjetër lloj energjie. Nëse duam mbijetesën e specieve, nëse duam të gjejmë kuptimin e jetës, nëse duam të shpëtojmë botën dhe çdo gjallesë që e popullon atë, dashuria është përgjigja e vetme.

Mbase nuk jemi ende gati të shpikim një bombë me dashuri, një pajisje të fuqishme që të shkatërrojë urretjen, egoizmin dhe lakminë që po gërryejnë planetin. Megjithatë, çdo individ mbart një "gjenerator" të vogël, por të fuqishëm dashurie, energjia e të cilit pret të çlirohet. Atëherë kur të mësojmë të japim dhe marrim këtë energji universale, e dashura ime Lieserl, do të konfirmojmë se dashuria sundon mbi gjithçka; dashuria është e aftë të kapërcejë mbi çdo gjë, sepse dashuria është jetë. Jam thellësisht i penduar që nuk kam qenë i aftë të shpreh çfarë kam në zemër, që ka rrahur për ty gjatë gjithë jetës sime. Mbase është vonë për të të kërkuar ndjesë. Por, meqë koha është relative, dua të të them se të dua. Falë teje kam gjetur përgjigjen themelore.

Babai yt, Albert Ajnshtajni".

JUDA I AMOS OZ: Izraeli si i vetmi atdhe për hebrenjtë e palestinezët

Si mund të jetojnë në të njëjtën shtëpi, një patriot që ka humbur birin e vetëm në luftë, me një burrë idealist që duke besuar te bashkëjetesa ka qenë gjithnjë kundër luftës? Valdi dhe Abravaneli përfaqësojnë dy kategoritë e popullit- ata që nuk e ndajnë atdheun dhe ata që e bashkëndajnë; një patriot dhe një 'judë' modern. Por çfarë ishte Juda dhe a mos e kemi

keqkuptuar? A mos ishte ai vallë një idealist tjetërsoj? A ishte Juda nxënësi që tradhtoi për 30 aspra apo njeriu që përmes këtij veprimi i dha botës një perëndi, duke na dhënë edhe mundësinë për ta njohur? Historia e Izraelit, besimeve, ikjeve dhe kthimeve përcillet përmes pyetjeve të Shmuel Ashit, rrëfimeve të Gershom Valdrit dhe ndërhyrjeve e pranisë së Atalias, e bija e

Shelatiel Abravanelit, e bashkëshortja e një të rëni në luftë. Oz sjell ata që besuan e ata që nuk besuan te perëndia dhe shteti, sjell pushtetin dhe forcën, në një roman mbërthyes ku kohët dhe vendet pasqyrohen përmes tre personazheve, të zymtë e krenar, të thjeshtë e të mëdhenj, të struktur e plot gjurmë, të heshtur e shumë kumtues. Janë në ta 'tri vetët' e

Ozit që rrokin botëkuptime e debate. Romani i botuar nga 'Skanderbeg books' është përkthyer nga Alina Karauli, e cila në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" ndalet te konceptet e Amos Ozit, luftërat e tij dhe jetën e veprën e një shkrimtari të jashtëzakonshëm, që i ka bërë popujt ta duan ndryshe Izraelin. Duke shpjeguar shtresëzimet e vetë Amos Ozit, Karauli, nga josh më shumë drejt faqeve të romanit, kur personazhet rrëfejnë Izraelin e tyre, herë herë edhe me drojën e frikën e atyre që sapo zbritën në mol u dërguan në luftë.

Kjo intervistë është veçse një copëz e botës së Ozit, një copëz jete e një copëz besimi. Ky është një prej librave për të cilët duhet shkruar në panair- një ndër vullnetet e fundme të autorit.

"Juda" është një roman që i qaset ndryshe dishepullit që tradhtoi Perëndinë. Cili ka qenë raporti i Amos Oz me krishterimin dhe me hebrenjtë?

Interesi i Amos Ozit për krishterimin dhe figurën e Jezusit ka qenë i hershëm. Në moshë shumë të re lexoi Dhjatën e Re dhe siç e ka përkthyer edhe vetë "ra në dashuri me Jezusin, ndonëse nuk pajtohej me shumë prej ideve të tij". Xhaxhai nga babai i Amos Ozit, Joseph Klausner, historian dhe profesor i letërsisë hebraike, u bë shumë i njohur me librin e tij mbi Jezusin e Nazaratit, i cili sipas Klausnerit "nuk ishte aspak i krishterë, por kokë e këmbë hebre. Ai kishte lindur hebre, vdiq si hebre dhe kurrë nuk i shkoi ndërmend të themelonte një fe të re". Çështja e hebrenjve, konflikti Izrael-Palestinë kanë qenë gjithnjë shqetësim i madh për shkrimtarin, i cili jo pak herë ka qenë edhe shumë kritik ndaj politikave të Izraelit duke u përkufizuar shpesh si "tradhtar" për qëndrimet e tij.

Ai shpall se pa Judën nuk do të kishte krishterim dhe se m'u për këtë, ai duhej mbajtur mend ndryshe. Jep po aq kritika për Jezusin, sa edhe mësimet e tij më të mira. Ai, thotë Oz përmes Shmueli Ashit, ishte i krishteri i parë që besoi. Si arrihet deri në këtë logjikë?


Shmuel Ashi është ateist, megjithatë e tërheq shumë figura e Jezusit, por sidomos Juda, një figurë qendrore në historinë e antisemitizmit. Ai debaton çdo natë me Gershom Valdrit,

një tjetër personazh i rëndësishëm i romanit, mbi sjelljen e Judës dhe kthesën që ndodhi në histori pas kryqëzimit të Jezusit duke e bërë vetë emrin e Judës sinonim të tradhtarit. Juda u bë arketipi më i urreyer dhe më i përçmuar i hebreat. Mishërim i tradhtisë, mishërim i judaizmit, mishërim i lidhjes mes judaizmit dhe tradhtisë. Shmuel Ashi përpiqet t'i argumentojë idetë e tij duke u bazuar në vepra të studiuesve të ndryshëm dhe beson se tradhtari më i famshëm në botë ishte në të vërtetë i pari dhe më i devotshmi i krishterë. Ai e sheh Judën si një idealist, që kurrë nuk e tradhtoi Jezusin, përkundrazi, donte ta provonte madhështinë e tij para gjithë botës. Pa Judën, thuhet në libër nuk do të kishte pasur kryqëzim, dhe po të mos kishte pasur kryqëzim, nuk do të kishte pasur as Krishterim, dhe kush mund të thotë se si do të ishte fati i hebrenjve pa historinë e Judës?

Oz ndalet gjatë te lufta, lufta për të njëjtën tokë mes hebrenjve dhe arabëve. Ai thotë se hebrenjtë e shpëtuar nga Holokausti, u dërguan nga moli në fushëbetë. Çfarë e ka nxitur atë të jetë i kritik e gjykues, po aq edhe i qartë se dy popujt duhej të luftonin për të njëjtën tokë?

Amos Oz ka mbështetur për një kohë të gjatë idenë e një zgjidhjeje të konfliktit përmes krijimit të dy shteteve që do të ndanin të njëjtin territor. Është i vetmi atdhe që kanë hebrenjtë dhe i vetmi atdhe që kanë palestinezët, thotë autori, ndaj dhe e sheh Izraelin si një shtëpi të vogël, e cila duhet ndarë, ngase është e kotë të fantazohet se pas kaq vitesh gjakderdhje mund të ketë një zgjidhje tjetër. "Të dy popujt janë konsumuar nga urrejtja dhe helmi, të dy kanë dalë nga lufta me idenë e ngulitur për hakmarrje, të zhytur në vetëkënaqësi. Lumenj të tërë hakmarrjeje dhe vetëkënaqësie. Dhe rrjedhimisht, gjithë vendi është mbuluar nga varrezat dhe rrënojat e qindra fshatrave të shkatërruara", thotë Atalia, personazhi i tretë i romanit.

– Del në pah edhe mosbesimi i autorit ose më i gjerë se i tij te shtetet- shtetet që ndajnë njerëz; te kombet e nacionalizmat; mandej te pushteti si një mjet që e shtyn katastrofën po nuk i zgjidh problemet. Lexuesi



gjen mesazhe të shumëllojshme. A ka qenë vetë Oz mosbesues ndaj këtyre nocioneve?

“Juda” është një roman me shumë shtresëzime, ku sigurisht një vend të rëndësishëm zë edhe çështja e kombeve dhe nacionalizmit. Shelatiel Abravaneli, një personazh në hije, po mjaft i rëndësishëm, një Judë modern, si të thuash, u jep zë këtyre teorive. I quajtur prej të gjithëve tradhtar, Judë, a është ai vërtet i tillë apo është një pararendës dhe mbështetës i një ideje ndryshe për zgjidhjen e konfliktit? Abravaneli mendon se Izraeli duhet të jetë një shtet ku të gjithë mund të jetojnë së bashku. Abravaneli është Juda i Amos Ozit, ai nuk kryen vetëvrasje në fund si Juda, por veçimi dhe shkëputja e tij nga shoqëria është e plotë. Shmueli e zbulon pak nga pak këtë personazh dhe gjithçka që ai ka përfaqësuar dhe mbështetur. Por Oz nuk e ka idealizuar Abravanelin, përballë tij ka vendosur Gershom Valdën, një patriot që besonte fort te shteti i Izraelit dhe që pas luftës dhe humbjes së birit të vetëm jetoi nën një çati me Abravanelin në një heshtje të hidhur. Vetë Amos Ozi është shprehur se personazhi i Abravanelit nuk ka një natyrë të pëlqyeshme, të këndshme, përkundrazi, por se ai ndihej mirë kur lexuesit i përqafojnë idetë e Abravanelit.

Shmuel Ashi është filli lidhës mes historisë së Judës, Jezusit, krishterimit dhe ngritjes së shtetit hebre në një tokë që u qepremtuar në një libër të shenjtë çka përfshinte dëbimin e arabëve. Ai është filli lidhës mes luftës dhe Biblës, mes Atalia Abravanelit dhe logjikës së luftës, urrejtjes ndaj luftës. Ç’mesazh jep një djalosh që ka humbur busullën dhe është në kërkim të vetes?

Shmuel Ashi është një djalë i ndrojtur, emotiv, që në fillim të romanit gjendet në një udhëkryq, ka braktisur studimet, është braktisur nga e dashura, është larguar nga familja dhe teza e tij ka mbetur vendnumëro. “Juda” është një roman mbi tre njerëz të huaj, të panjohur, antagonistë, por që në fund arrijnë ta ndryshojnë sado pak njëri-tjetrin, “një mrekulli e vogël e Jeruzalemit”, siç e përkufizonte autori. Përsiatjet e gjata e çojnë Shmuelin në përfundimin se kushdo që ka dëshirë të ndryshojë, do të konsiderohet gjithnjë tradhtar nga ata që nuk janë të aftë për ndryshim, që i tremben për vdekje ndryshimit, që nuk e kuptojnë dhe e urrejnë atë.

Nëse Gershom Valdi përfaqëson baballarët e heronjve që besuan dhe humbën bijtë, dhe Atalia përfaqëson vejushat që nuk besuan e prapë humbën bashkëshortët, a është Shmuel Ashi ai brezi që vjen pa ditur se sa është humbur për të pasur

lirinë, atë tokë nën këmbë e atë qiell mbi krye?


Shmuel Ashi është një personazh idealist dhe deri diku naiv, por është inteligjent dhe ka etje për të mësuar e për t’u thelluar në të vërtetat historike. Qëndrimi pranë Valdës, dashuria për Atalian dhe njohja me idetë e Abravanelit bëjnë që edhe bindjet e tij të evoluojnë. Ai mbetet gjithnjë një personazh i dyzuar, por qëndrimi i shkurtër në atë shtëpi të izoluar, të mbyllur për të gjithë, i jep në fund çelësin për t’i parë gjërat më kthjellët, të zhveshura nga idealizmi i tepruar. Në fund të romanit Shmuel Ashi është sërish në mëdyshje se çfarë e pret më pas dhe duket sikur përsërit me mendje pyetjen e heshtur të Abravanelit nëse ia vlejti gjithçka.

Ozi përmes historisë së një familjeje dhe të një qyteti rrok historinë e një kombi, të disa brezave dhe prek plagën më të madhe, atë të moskuptimit a keqkuptimit ndaj hebrenjve në shekuj. Sa e ndjente këtë pezëm shkrimtari që tejkalon historinë duke e rrëfyer atë me një ëmbëlsi që të josh drejt fundit përmes një panorame që tregon se hebrenjtë janë vetëm një popull, me mëkatet e lavdinë e vet, si çdo popull tjetër?

Është padyshim një brengë e madhe që e ka ngacmuar gjatë, por në roman nuk ka sentimentalizëm, madje shpesh autori është i mjaft i ashpër. Me gojën e personazheve të tij ai mbërrin në përfundimin se flamujt, uniformat, bankënotat, daultet dhe trumbetat, sakrifikimi i një brezi të tërë, përzënia e arabëve nga shtëpitë e tyre vetëm për të pasur një shtet hebre derdhi lumenj gjaku të pafajshëm. Duke eksploruar temën e tradhtisë, Amos Ozi trajton një çështje kyçe të krijimtarisë së tij: ekzistencën e Izraelit, duke vënë në diskutim vetë kuptimin e shtetit, themelimin e tij dhe konfliktin me palestinezët. Romani ka një konotacion të qartë politik.

Si ka qenë procesi i përkthimit?

Është një libër që më ka dhënë shumë kënaqësi gjatë përkthimit, sepse më pëlqen stili i shtruar dhe i thukët i Amos Ozit. Më tërhoqi që në fillim mënyra se si përmes përshkrimit me hollësi dhe shpesh të përsëritur të përditshmërisë së personazheve autori krijon idenë e një tabloje statike, sikur asgjë e rëndësishme nuk ndodh, por në të vërtetë kjo palëvizshmëri fsheh brenda vetes shumë konflikte, të cilat zbulohen pak nga pak. Jam munduar të ruaj frazën e rrjedhshme dhe inteligjente, karakteristike për këtë shkrimtar, jam munduar të ruaj atë atmosferën e zymtë, të trishtuar, deri diku edhe misterioze që përcjell librin, dhe sidomos t’i sjell personazhet kryesore me tre zëra të ndryshëm. Është një



libër që ka dashur kohën e vet për t’u përkthyer, ndonjëherë kam pasur edhe dyzimet e mia sepse libri është shumë i pasur me referenca historike. Por takimi me autorin ishte ndihmë shumë e madhe për mua dhe vetë vizita në Jeruzalem më futi më tepër në atmosferën e romanit, ndonëse ngjarjet zhvillohen shumë vite më parë dhe në një Jeruzalem të ndryshëm nga ai që pashë unë.

Ju keni pasur një takim me Ozin. Si e përshkruani atë?

E kujtoj si njeri mjaft të vëmendshëm ndaj detajeve dhe me një kujtesë të shkëlqyer. Ne ishim gjashtë përkthyes dhe kuptohet që secili prej nesh kishte pyetjet e veta, shpesh të shumta. Po kjo nuk e lodhte Ozin, përkundrazi,

çdo pyetje i dukej interesante dhe shpesh në ato ditë na thoshte se gjithnjë kishte dashur të kishte një takim të tillë me të gjithë përkthyesit e tij rreth një tryeze. Më bëri pyetje për Shqipërinë dhe ndonëse u tregua modest dhe tha se nuk kishte shumë informacion, konstatova me habi se përkundrazi, kishte mjaft njohuri dhe madje bëri edhe një paralelizëm mes dy vendeve tona, si vende të vogla dhe me histori të trazuar. Nuk mund të rri pa përmendur bashkëshorten e tij Nilin, që e shoqëronte ngado, një grua inteligjente dhe me shumë humor që më ndihmoi për t’i kapërcyer emocionet që kisha në takimin e parë me Amos Ozin.

Ky roman u shkrua më 2014. Ç’gjë e nxiti shkrimtarin t’i kthehej fesë, përplasjes fetare, qytetërimeve në muzgun e jetës?

Ky roman ishte fryt i një pune shumë të gjatë. Autori e kishte menduar dhe bluar me vite të tëra idenë e romanit. Kishte lexuar shumë, kishte bërë një punë të hollësishme kërkimore dhe ndonëse mendonte se kishte shkruar vërtet diçka të mirë, kishte ngurruar përsëri para se ta botonte. Siç na rrëfeu, Kapitullin 47, pa dyshim kapitulli më i bukur i librit, e kishte shkruar dhe rishkruar 15-16 herë. Është skena e kryqëzimit për të cilën është shkruar pafund, ndaj dhe duhej të ishte diçka e veçantë, që të mbetej në kujtesë dhe nuk ka dyshim që ia ka dalë. /Fatmira Nikolli -gsh.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Kosova pa Muriqin kundër Çekisë dhe Anglisë

Futbollistët e Kosovës i kanë vazhduar stërvitjet të martën për ndeshjen kundër Çekisë që zhvillohet të enjten nga ora 20:45. Lajm i keq për "dardanët" është mungesa e sulmuesit kryesor Vedat Muriqi në të dyja ndeshjet e fundit kualifikuese për Kampionatin Evropian

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të martën në mbrëmje e ka zhvilluar edhe stërvitjen e dytë për ndeshjen kualifikuese për Kampionatin Evropian ndaj Çekisë, e cila zhvillohet nesër (e enjte). Mirëpo lajm i keq për përzgjedhësin Bernard Challandes dhe gjithë shqiptarët është fakti se sulmuesi kryesor i "dardanëve", Vedat Muriqi, do të mungojë në ndeshjen ndaj Çekisë, por edhe në ndeshjen e fundit kualifikuese kundër Anglisë.

Të martën Federata e Futbollit e Kosovës konfirmoi lajmin se

Muriqi mungon për shkak të lëndimit që pësoi në ndeshjen e fundjavës me skuadrën e Fenerbahçes në Turqi. "Përkundër përpjekjeve maksimale dhe dëshirës së madhe të futbollistit për t'i ndihmuar bashkëlojtarët në këto ndeshje të rëndësishme, pas ekzaminimeve të bëra mjekësore dhe konsultimeve edhe me ekspertë të kësaj fushe në Zvicër, ka rezultuar që paraqitja e tij është e pamundshme", thuhet në njoftimin e FFK-së. Megjithatë, edhe përkundër mungesës së Muriqit, optimizmi për fitore në kampin e "dardanëve" në ndeshjen e 14 nëntorit është i madh.

Kapiteni Samir Ujkani ka thënë se përballja me çekët është finale

për Kosovën dhe atje duhet të merret maksimumi për të bërë realitet më pas ëndrrën e kualifikimit në Evropian. "Ne po shohim ndeshjen e së enjtes, që është një finale për ne. Atje duhet patjetër ta japim maksimumin dhe të marrim rezultat maksimal. Duhet t'i marrim pikët për ta bërë ëndrrën realitet. Ky është qëllimi ynë. E dimë që nuk do të jetë aspak e lehtë", ka thënë Ujkani.

Edhe mbrojtësi i Kosovës, Amir Rrahmani, i cili në ndeshjet e fundit e ka bartur shiritin e kapitenit të Kosovës, ka shprehur optimizëm për ndeshjen e radhës kualifikuese. Mbrojtësi që aktivizohet në kampionatin italian me Veronën ka thënë se



presioni të enjten është mbi Çekinë. "E dimë që është një ndeshje shumë e vështirë sepse luajmë ndaj kundërshtarit për vendin e dytë. Takimin e parë në shtëpi e kemi fituar 2-1, por atje do të jetë shumë ndryshe, me shumë presion. Presioni nuk do të jetë vetëm mbi ne, madje

Çekia do të ketë më shumë presion. Ndoshta është më mirë për ne që ata kanë më shumë presion për fitoren. Kështu që do të jetë një përballje me tension, por qëllimi ynë kryesor është ta japim maksimumin. Besoj se rezultati do të vijë", ka deklaruar Rrahmani.

Vazhdojnë mashtrimet me biletat për ndeshjen Kosovë - Angli

Tregu i zi duket se do të jetë e vetmja rrugë për adhuruesit e futbollit që të sigurojnë një biletë për ndeshjen e 17 nëntorit në mes të Kosovës dhe Anglisë, e cila zhvillohet nga ora 18:00 në stadiumin "Fadil Vokrri". Të martën ishte pritur që biletat të dalin në treg, por faqja e autorizuar për shitjen e tyre për orë të tëra ka qenë jashtë funksionimit

"Epoka e re"

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Mashtrimet me bileta të ndeshjeve të Përfaqësueses së Kosovës në futboll kanë vazhduar edhe të martën. Pavarësisht se "dardanët" më 17 nëntor e zhvillojnë ndeshjen kryesore ndaj një kundërshtareje të fortë siç është Anglia, kjo nuk ka ndikuar që të eliminohen problemet me shit-

jen e biletave. Në orën 16:00 ishte paralajmëruar se biletat për ndeshjen kualifikuese për Kampionatin Evropian në mes të Kosovës dhe Anglisë do të dalin në shitje nga uebfaqja "tiks.app", por një gjë e tillë nuk ndodhi sepse faqja vazhdimisht ishte jashtë sistemit. Më pas kompania në fjalë lëshoi një njoftim se faqja e vet ka rënë nga sistemi si pasojë e kërkesave të mëdha dhe se shumë shpejt do të jetë në



funkcion. "Për shkak të ngarkesës shumë të madhe qasja në uebfaqen tonë momentalisht është e pamundur. Shumë shpejt faqja do të jetë aktive përsëri.

Shpresoj të kemi mirëkuptimin tuaj pasi që kërkesa është jashtëzakonisht shumë e madhe. Faleminderit!", thuhet në njoftimin e "Tiks.app".

Rikthimi në sistem i kësaj faqe nuk ndodhi për orë të tëra, derisa nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka reaguuar edhe zëdhënësi i Prokurorit të Shtetit, Ekrem Lutfiu. "E qysh me marr bileta online kur bie prej sistemi sajti i shitjes së biletave për ndeshjen Kosovë-Angli??? Tmerr bre kjo është, të dështuar me qëllim, dallavere fund e krye!", ka shkruar Lutfiu.

Adhuruesit e futbollit duket se rrugën e vetme për të siguruar një biletë që t'i shohin nga afër idhujt e tyre duhet ta kërkojnë në tregun e zi sikurse që ka ndodhur shumë herë edhe në ndeshjet e kaluara. Përballja e Grupit A kualifikues në mes të Kosovës dhe Anglisë zhvillohet të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri" me fillim nga ora 18:00.

Prishtina fiton bindshëm në Qipro

Prishtinë, 12 nëntor - Sigal Prishtina ka triumfuar në Qipro ndaj Apoel Nicosia me rezultat 80:107 (23:31, 23:21, 9:28, 25:27), në ndeshjen e katërt në Grupin C të FIBA Europe Cup. Prishtinasit ishin të vendosur për të fituar dhe këtë e treguan në çerekun e parë, që e fituan 23:31. Sidoqoftë, perioda e dytë ishte më e barabartë dhe përfundoi me rezultat 23:21 në të mirë të vendësve. Dallimi u bë në

periudhën e tretë, të cilën bardhekaltrit e fituan 9:28 për të shkuar drejt një fitore të sigurt. Epërsinë e lartë e ruajtën edhe në dhjetëminutëshin e fundit, që e fituan 25:27 dhe triumfuan në fund 80:107. Dmitri Thompson ishte më i dalluari te vendësit me 22 pikë, gjashtë kërcime dhe katër asistime, derisa te Prishtina më i miri ishte Divine Myles me 31 pikë, gjashtë kërcime e gjashtë asistime.

Ai u ndihmua nga Mikailë Timusiq me 23 pikë, Fahro Alihoqhiq me 15 pikë e 10 kërcime, si dhe Jonathan Wade me 13 pikë e shtatë kërcime. Sigal Prishtina nga katër ndeshje të zhvilluara ka dy fitore dhe dy humbje, derisa Apoel ka katër humbje në po aq takime të zhvilluara. Në përballjen e ardhshme, më 20 nëntor, në kryeqytet, prishtinasit do të ndeshen me skuadrën gjermane Bayreuth.



Loriana Kukës i ngritët Bursa Olimpikë 'Tokio 2020', Orges Arifit i ndalet

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Paraqitjet e mira gjatë vitit 2019 të xhudistes Loriana Kuka kanë bërë që të ngritën edhe të ardhurat e saj nga Bursa Olimpikë "Tokio 2020". Solidariteti Olimpik (SO) i Komitetit Olimpik

Ndërkombëtar (IOC) ka aprovuar kërkesën e Komitetit Olimpik të Kosovës për t'ia ngritur bursën Olimpikë Lorianës nga 150 dollarë në 500 dollarë. Loriana (-78 kg) gjatë këtij viti ka fituar medaljen e bronzit në

Kampionatin Botëror "Tokio 2019" si dhe medaljen e bronzit në Lojërat Evropiane "Minsk 2019". Suksesi nuk i ka munguar as në garat Grand Slam e Grand Prix. Ajo ndodhet brenda normës Olimpikë "Tokio 2020". Me

propozimin e KOK-ut, SO i IOC i ka ndaluar Bursën Olimpikë karateistit Orges Arifi, i cili ka vendosur të garojë për Kombëtarën e Shqipërisë. Bursa Olimpikë "Tokio 2020" marrin 18 sportistë.



'Dardanët' me sloganin 'Welcome and Respect' do t'i presin anglezët

PRISHTINË, 12 NËNTOR - "Dardanët" kanë mbajtur të martën konferencë për media para dy ndeshjeve të rëndësishme të Kosovës në kualifikimet për "Euro 2020". Kryetari i tifogrupit "Dardanët", Lulzim Berisha, ka thënë se janë bërë të gjitha përgatitjet para ndeshjeve me Çekinë dhe Anglinë dhe, sipas tij, sloganin zyrtar do të dalë pikërisht nga grupi i "Dardanëve". "Mendoj se prej këtu duhet të dalë sloganin për pritjen e anglezëve. Ne e kemi marrë një iniciativë për shkak të rëndësisë së ndeshjes që do të zhvillohet. Ne e kemi organizuar dhe do të dalim me një slogan zyrtar nga 'dardanët'. Për këtë kemi një bashkëpunim të mirë me komunën e Prishtinës", ka thënë Berisha.

Vjosa Berisha, anëtare e grupit të femrave të "Dardaneve", tregoi më shumë rreth sloganit të cilin do të publikojnë disa ditë para ndeshjes të së dielës. "Welcome and respect" është sloganin i mikpritjes së Anglisë. Këtu përfshihen shumë aspekte. Normalisht mikpritja që është virtyt tradicional i Kosovës. Vendi ynë ka marrë shumë përkrahje nga Anglia në shumë aspekte, por edhe në pavarësinë e Kosovës. Ky mesazh do të vijë edhe në kuadër të racizmit, për nder të lojtarëve me ngjyrë të Anglisë të cilët janë abuzuar shumë në ndeshjet e tjera", ka



deklaruar Berisha. Zëdhënësi i "dardanëve", Berat Buzhala, u shpreh se janë përgatitur maksimalisht dhe shpreson që asgjë e keqe nuk do të ndodhë. "Ne jemi përgatitur maksimalisht për këtu. Jemi të bindur që nuk do të ndodhë asgjë e keqe. Kërkojmë nga ju që të shpërndahet sa më shumë ky slogan", ka pohuar Buzhala.

Ndërsa Ardian Berisha, koordinator i eventeve kulturore sportive nga Komuna e Prishtinës, konfirmoi bashkëpunimin për këto dy ndeshje të Kosovës. "Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me 'dardanët' dhe FFK-në fillimisht do ta transmetojnë ndeshjen ndaj Çekisë dhe më pas do të dalin me sloganin zyrtar. Do të këtë aktivitete të ndryshme për mikpritjen e tifozëve të Anglisë

dhe më pas do të transmetohet edhe ndeshja ndaj Anglisë ku shpresojmë që do ta festojmë edhe kualifikimin për 'Euro 2020', ka deklaruar Berisha.

Aktori Fatmir Spahiu u shpreh se me kënaqësi e kanë pranuar ftesën për bashkëpunim nga kryetari i "dardanëve". "Ky grup që po e shihni para jush është vetëm një pakicë e atyre që janë angazhuar të japin një mikpritje të mirë për tifozët anglezë. Ne dimë për një marrëdhënie speciale dhe falënderuese që kemi ndaj Anglisë. Ne e kemi pranuar me kënaqësi ftesën e kryetarit të 'Dardanëve' për të bërë një pritje madhështore për tifozët dhe kombëtarën e Anglisë", u shpreh Spahiu. Kosova të enjten zhvillon ndeshjen si mysafir ndaj Çekisë, ndërsa të dielën e pret Anglinë në Prishtinë.

Toronto gabon ndaj clippersave, Golden State zhytet në krizë

LOS ANGELES, 12 NËNTOR - Pas fitores 24 orë më parë ndaj Lakersit, këtë herë skuadra e Torontos ka dalë humbëse në përballjen me ekipin tjetër të Los Anxhelosit, atë të Clippersit. Vendësit fituan 98-88, ndeshje ku ekipet u mbrojtën mirë, me Clippersin që bëri dallimin në parket.

Lou Williams, që e nisi ndeshjen nga stoli, ishte lojtari më i mirë për vendësit, me 21 pikë, mbështetur nga Harrel me 14 pikë. Vijon momenti i keq për skuadrën e Golden State, që u mund 122-108 nga Utah Jazzi. Për nënkampionët e NBA-së ndihet mungesa e yjeve, Curry e Thompson (Russell më i miri me 33 pikë), ndërsa për Jazzin shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë (Gobert 25 pikë e 14 rebounde).



Jashtë fushës fiton edhe Houstoni, që mundi 122-116 New Orleansin, ndeshje me rivalitet dhe emocione. Harden me 39 pikë e Westbrook me 26 ishin liderë në fushë për ekipin teksan.

REZULTATET

Detroit - Minnesota	114-120
Boston - Dallas	116-100
San Antonio - Memphis	109-113
New Orleans - Houston	116-122
Golden State - Utah Jazz	108-122
Clippers - Toronto	98-88

SHKURT

Interesim i jashtëzakonshëm për ndeshjen Shqipëri - Francë

Tifozët shqiptarë kanë treguar një interesim të jashtëzakonshëm për ta parë nga afër ndeshjen kualifikuese për Kampionatin Evropian në mes të kuqezinjve dhe Francës. Në këtë ndeshje do të përurohet edhe stadiumi "Arena Kombëtare". Sipas mediave në Shqipëri, janë mbi 80 000 tifozë që kanë kërkuar një biletë për ndeshjen që zhvillohet më 17 nëntor nga ora 20:45, derisa kapaciteti i stadiumit është 22.500 vende.

Mick Schumacheri, i gatshëm të garojë në Formula 1

Mick Schumacher, djali i shtatë herë kampionit të botës në Formula 1, Michael Schumacher, aktualisht garon në botërorin e Formulës 2 me makinën italiane Prema. Ai ka deklaruar se nuk do ta refuzonte një ftesë nga Formula 1, pavarësisht se cila skuadër do ta kërkonte. "Nuk ka qenë një sezon i lehtë, përkundrazi. Çdo ditë, çdo garë mësojmë dhe përmirësohemi me këtë sport dhe atë që na pret në të ardhmen. Këtë sezon kam kuptuar se sa e rëndësishme është të mos dorëzohesh", ka deklaruar Mick Schumacher. "Nëse do të kem një ofertë nga Formula 1 nuk do të tërhiqesha pas. Do ta mirëprisja. Ndaj, kalimi im në Formula 1 që sezonin tjetër është plotësisht i mundur", ka shtuar 20-vjeçari.

Ten Hag: De Ligt do të bëhet mbrojtësi më i mirë në botë

Trajneri i Ajaxit, Erik ten Hag, beson që Matthijs de Ligt do të bëhet mbrojtësi më i mirë në botë. Mbrojtësi holandez gjatë afatit veror për 75 milionë euro dhe brenda një kohe të shkurtër ka arritur të hyjë në formacionin e parë. "Jam krenar për gjërat që ka arritur në një kohë të shkurtër te Juventus dhe besoj se do të vazhdojë kështu. Nuk e di nëse De Ligt ka treguar 60-80 % të potencialit, por jemi duke folur për një ndër mbrojtësit më të mirë në Evropë dhe nuk kam dyshim që së shpejti do të jetë numër një në këtë pozitë", ka thënë Ten Hag.

Emery nuk largohet nga Arsenalit

Pavarësisht prej rezultateve të dobëta në javët e fundit, trajneri Unai Emery do ta vazhdojë punën tek Arsenalit. Kanë qenë vetë drejtuesit më të lartë të Arsenalit ata që i kanë konfirmuar besimin teknikut me shpresën se skuadra do t'u rikthehet rezultateve pozitive.

Florenzi kërkon të largohet nga Roma

Mbrojtësi Alessandro Florenzi pritet të largohet nga skuadra e Romës pasi nuk është i kënaqur me minutat e hapësirës së lojës në këtë edicion. Lajmi është bërë me dije nga "Gazzetta dello Sport". Florenzi ka kërkuar largimin nga "Olimpico" gjatë afatit kalimtar të janarit dhe interesim për shërbimet e tij tashmë kanë shprehur Interi, Fiorentina, Sampdoria dhe Cagliari.

Bayerni e mendon Alonson për trajner

Bayern Munchen e ka shkarkuar ditë më parë trajnerin Niko Kovaç dhe është duke e kërkuar zëvendësuesin e kroatit. "DailyStar" zbulon se ekipi gjerman është duke u interesuar për ish-futbollistin e vet Xabi Alonso. Spanjollit është trajner në skuadrën e dytë të Real Sociedadit, kurse Bayernin mund ta drejtojë deri në fund të këtij edicioni.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 572/1
Dt. 12.11.2019

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2019/2020 KLASËT E
10-ta PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË PROFESIONAL –
MESIMI PER TE RRITUR

Për plotësimin e vendeve të lira regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Shkollën e Mesme të Lartë Teknikë "11 Marsi" në Prizren, shpallim këto drejtime:

I. Makineri

1	Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit	1 Paralele	24 nxënës
2	Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit	1 Paralele	24 nxënës
3	Automekanik	1 Paralele	24 nxënës
4	Dizajn i Metaleve	1 Paralele	24 nxënës

II. Ndërtimtari

1	Arkitekturë	1 Paralele	24 nxënës
2	Ndërtimtari	1 Paralele	24 nxënës
3	Gjeodezi	1 Paralele	24 nxënës

III. Artet e aplikuar

1	Dizajn Veshje	1 Paralele	24 nxënës
2	Dizajn Grafik	1 Paralele	24 nxënës

IV. TRANSPORT

1	Trafik Rrugor	1 Paralele	24 nxënës
---	---------------	------------	-----------

V. Elektroteknikë

1	Dizajn Softuer,	1 Paralele	24 nxënës
2	TIT	1 Paralele	24 nxënës
3	Informatikë	1 Paralele	24 nxënës
4	Instalues Elektrik	1 Paralele	24 nxënës
5	Makina Elektrike	1 Paralele	24 nxënës

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimin për të rritur në shkollën profesionale, për vitin shkollor 2019/2020, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe që janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve, bëhet 15 ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës SHMLT "11 Marsi" në Prizren, nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollën përkatëse 3 (tri) ditë pas mbylljes së konkursit.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA

Prishtinë, 13. 11. 2019

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 30, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, neni 32, Ligjit të Punës Nr.03/L212, Udhëzimit Administrativ(MPMS) NR.07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik shpallë:

KONKURS

1 (Një) Hulumtues të pavarur për shek. XVI-XVIII - zgjedhje

Kandidati për pozitën Hulumtues i pavarur duhet të plotësojë këto kushte:

- Të ketë të regjistruara studimet e doktoraturës për periudhën përkatëse,
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore nga periudha e caktuar,
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Njohja e gjuhës së huaj është përparësi.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Vërtetimin për vijimin e studimeve të doktoraturës
- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse (MA),
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime,
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata të hollësishe mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512 - 303, prej orës 08:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, pa numër (Ndërtesa e re e Institutit: afër Institutit Albanologjik të Prishtinës).



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA

Prishtinë, 13. 11. 2019

1. Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj djelatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, br 11/02 Maj 2013), Član 30, Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini, član 33 stav 5, član 51 i 52 obavljuje, Zakon Br. 03/L-212 o Radu, Administrativno Uputstvo (MRSZ) BR.07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru, objaviti:

KONKURS

1 (Jedan) Nezavisni istraživači za XVI-XVIII vekove- izbor

Kandidati za Nezavisna istraživač moraju ispuniti ove uslove:

- Upisane doktorske studije za navedeni period.
- Objavljeni radovi u naučnim časopisima iz navedenog perioda;
- Da su učestvovali u naučnim aktivnostima u zemlji i u inostranstvu.
- Poznavanje stranih jezika je prioritet.

Potrebna dokumentacija:

Kandidati treba da dostave sledeću dokumentaciju:

- Potvrda koja dokazuje da pohađa doktorske studije,
- Diploma za završetak relevantnih studija (MA)
- Izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
- Dokument izdat od nadležnog organa koji potvrđuje da nisu pod istragom,
- CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim novinama,

Aplikaciji se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira.

Kandidati izabrani na izornoj listi će biti obavesteni u pisanom obliku ili putem telefona u zakonskom roku Instituta i dužni su da sa sobom daju originalne dokumente o kvalifikacijama i obuci koja se provode za verifikaciju pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovom Br. Tel: 038 / 512 303, od 09:00 do 16:00 časova.

Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu : Institut Istorije u Prištini, bez broja (Novi Objekat u blizini Instituta Albanologjik i Prishtinës)

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Shaban Polluzha"
Komuna: Drenas
Data: 13.11.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/012-CS/1.1	Trajnim: Sigurimi i cilësisë në shkollë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Shaban Polluzha, Drenas. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës.

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Sigurimi i cilësisë në shkollë

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e menaxhimit, monitorimi, cilësisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e menaxhimit, monitorimi, cilësisë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Shaban Polluzha" Korreticë e Epërme, Drenas, më së largu deri më datën; 21.11.2019** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Drita Curri
Telefoni: 044/ 180 - 892
E-maili: dcurri@hotmail.com

"NATYRAL & KOSOVA" SH.P.K,
me numër fiskal: 601536404, me numër UNIK Identifikues: 810853681 dhe nr. Tvsh: 330285412, bënë shitjen e mallit:

PAGUAJ NJË, MERR NJË GRATIS
Shitja bëhet me shumicë dhe pakicë.
Adresa: Prishtinë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "ADA GROUP" SH.A. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb. 70966727 me nr. fis. 600985420.

► Valon Latifi nga Prishtina, shpall të pavlefshëm Licencën e punës të Mjekësisë me numër të licencës: KO-06624-01 e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.

► Florent Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën e diplomën shmm "Luciano Motroni" Prizren.

► Hysen Shala shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Merite Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shm "12 Maji" Ratkoc.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
Ministarstvo za Inovacije i Preduzetništvo
Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Datë: 12.11.2019

Vazhdim i ftesës për shprehje të interesit, objekt me qira

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është duke kërkuar objekt me hapësira të përshtatshme për zyra. Të gjithë të interesuarit, objektet e të cilëve përmbushin kushtet e përafërta të bashkangjitura në këtë shpallje, t'i dërgojnë ofertat me shprehje të interesit dhe dëshmi përkatës në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Rruga: "Bajram Kelmendi" K1 L1 - Prishtinë, deri më datë: **19.11.2019**, para orës: **14:00**. E-mail: burim.guri@rks-gov.net ose fizikisht në MIN.

Objekti duhet të ketë:

- Hapësirë e përgjithshme 800-900 m²,
- Hapësira të jetë sa më afër ndërtesës së Qeverisë,
- Parkingu për së paku 6 automjete zyrtare,
- Ngrohje qendrore çdo ditë pune,
- Pastrimi i objektit çdo ditë pune (të përfshihet në kuadër të çmimit të qerasë mujore e preferueshme),
- Ujë të ftohtë dhe ngrohët çdo ditë pune,
- Siguria e objektit 24 orë,
- Gjenerator për të furnizuar në tersi objektin me energji,
- Klimatizim,
- Dyshemeja e shtruar me parket ose laminat,
- Ne rast se objekti është me etazhe (kat) çdo etazh duhet të ketë se paku tualet (wc) për femra dhe meshkuj,
- Shkallë emergjente,
- Telefoni fikse,
- Hapësirë për dhomën e serverëve minimum 16m2,
- Hapësirë për depo minimum 16m2,
- Internet për gjithë hapësirën e punës (te përfshihet në kuadër të çmimit të qerasë mujore e preferueshme),
- Ndarja e hapësirave të dizajnet sipas nevojës së MIN-së për hapësira punë dhe për takime (e negociueshme),
- Objekti do të merret në shfrytëzim (qira) për 1 vit me mundësi vazhdimi,
- Çmimet pas marrjes se ofertës nga OE, mund të jenë të negociueshme,
- Objekti duhet të ketë leje ndërtimi dhe duhet të jetë në Prishtinë. Afërsia me ndërtesën e Qeverisë do të ketë përparësi,
- Të gjithë të interesuarit duhet të ofrojnë planin e objekteve të detajuara me metrazhe.